

2018

Aktiviteti Institucional i FSHZH-së

RAPORT VJETOR

Programet e Investimeve

Realizimi Financiar

Projekte te reja

Auditi i Brendshëm

Monitorimi & Vlerësimi

Ndërtimi i Kapaciteteve

Komunikimi & Informimi



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

SHKURTIME

AB	Auditi i Brendshëm
AKUK	Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve
BB	Banka Botërore
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BEI	Banka Europiane e Investimeve
CDF	Community Development Fund
CEB	Banka e Këshillit të Europës
DZHR	Departamenti i Zhvillimit Rajonal
FK	Fondi Kuvajtian
FS	Fondi Saudit
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
FUZR	Furnizimi me Ujë e Zonave Rurale
FZHR	Fondi për Zhvillimin e Rajoneve
GoA	Government of Albania - Qeveria Shqiptare
IDA	Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim
IDB	Banka Islamike e Investimeve
IPA	Instrumenti i Ndhmës së Paraaderimit Assistance
KD	Komiteti Drejtues
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
KZHR	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve
MIS	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit
MZHETTS	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes
NSPP	National Single Project Pipeline
NTA	Norway Trust Account
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
OFID	Fondi i OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar
PBA	Projekt Buxheti Afatmesëm
PK	Punët në Komunitet
PKST	Plani Kombëtar Sektorial i Turizmit
QSH	Qeveria Shqiptare
SIF	Fondi i Investimeve Sociale
ToR	Terma Reference
WBIF	Kuadri i Investimeve për Ballkanin Perëndimor (Western Balkans Investment Framework)

Pasqyra e lëndës

PËRMBLEDHJE	4
1. Programi i investimeve të Qeverisë Shqiptare	10
1.1 Projekti i Rehabilitimit të Segmenteve Rrugore Prioritare	10
1.2 Projekti i Investimeve Prioritare me impakt të lartë në zhvillimin dhe promovimin e turizmit, 2018 - 2019	11
1.3 Investime të Qeverisë Shqiptare 2015 - 2016	12
1.4 Bashkëpunimi i FSHZH me Fondin e Zhvillimit të Rajoneve në kuadër të Projekteve të Infrastrukturës Vendore	13
1.4.1 Zbatimi i projekteve të akorduara nga FZHR për periudhën 2014 - 2016	13
1.4.2 Studime, Projektme dhe Mbikqyrje për Fondin e Zhvillimit të Rajoneve 2016	14
1.4.3 Transferimi fondeve nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për financimin e projekteve në vazhdim të investimeve në kuadër të Programit Infrastruktura Vendore dhe Rajonale, FZHR.	15
2. Programi Punët në Komunitet IV "Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonës Bregdetare"	16
2.1 Masterplani i Alpeve	17
3. Rikonstruksioni i rrugës së Lumit të Vlorës	18
4. Projekti për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin (PZHIUT)	19
5. Programi i Rrugëve Lidhëse Rajonale	23
6. Programi i Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale	24
6.1 "Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III"	24
6.2 "Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale IV"	25
7. Programet e financuara nga IPA, Bashkimi Evropian	28
8. Projekti "Pastrimi i kanaleve kulluese në Shkodër dhe Fier"	37
9. Përgatitja dhe aplikimi për programe të reja	37
9.1 Programi për Zhvillimin e Integruar të Zonave me Potencial Turistik	37
9.2 Projekti Porta bregdetare e Alpeve	38
9.3 ALMONIT-MTC (Albania, Montenegro, Italy - Multimodal Transport Connectivity)	38
9.4 Programi i investimeve për zhvillim të integruar rajonal	38
10. AKTIVITETI INSTITUCIONAL	40
10.1 Menaxhimi Financiar	40
10.2 Organizim i ri institucional	48
10.3 Komunikimi dhe Marrëdhëniet me Publikun	48
10.4 Monitorimi dhe Vlerësimi	53
10.5 Auditimi i brendshëm	54
10.6 Burimet Njerëzore	56
10.7 Misione të donatorëve	58
11. AKTIVITETE TE TJERA	59
11.1 Krijimi i Agjencisë Ekonomike Mbështetëse	59
12. ANEKSE	61
Aneks 1. Lista e plotë e objekteve të Fondit Shqiptar të Zhvillimit me financim të FZHR-së (Dhjetor 2018)	62
Aneks 2. Lista e segmenteve rrugore që financohen në kuadër të Projektit për Rehabilitimin e Segmenteve Rrugore Prioritare 2017-2019 (Dhjetor 2018)	65
Aneks 3. Lista e objekteve të financuara nga Qeveria Shqiptare në kuadër të Projektit të Investimeve Prioritare me impakt të lartë në zhvillimin dhe promovimin e turizmit 2018 - 2019 (Dhjetor 2018)	67
Aneks 4. Lista e objekte të financuara nga Qeveria Shqiptare 2015-2016 (Dhjetor 2018)	69
Aneks 5. Informacion mbi nënprojektet e programit "Punët në Komunitet IV", financuar nga CEB, Qeveria Shqiptare dhe NJQV-të përfituese (Dhjetor 2018)	70
Aneks 6. Informacion mbi projektin e Rrugës së Lumit të Vlorës Faza I, financuar nga Fondi Kuvajtian (Dhjetor 2018)	71
90.4 km	71
Aneks 7. Informacion mbi Projektin për Zhvillimin e Integruar dhe Turizmin, financuar nga Banka Botërore (Dhjetor 2018)	72
Aneks 8. Informacion mbi skemat e ujësjellësave të përzgjedhur për përgatitjen e projekteve teknike në kuadër të programit "FUZR III", financuar nga KfW, IPA 2013 dhe Qeveria Shqiptare (Dhjetor 2018)	73
Informacion mbi skemat e ujësjellësave shtesë të përzgjedhur për përgatitjen e fizibiliteteve teknike në kuadër të programit "FUZR III", financuar nga KfW, IPA 2013 dhe Qeveria Shqiptare (Dhjetor 2018)	74
Aneks 9. Informacion mbi nënprojektet e programit "Rruget Lidhëse Rajonale", financuar nga WB dhe BERZH, Qeveria Shqiptare dhe NJQV-të përfituese (Dhjetor 2018)	74
Aneks 10. Realizimi i zërave të buxhetit për vitin 2018 (sipas Donatorëve - Euro)	75
Aneks 11. Shpenzimet sipas Donatorëve dhe Kategorive për vitin 2018 (në Euro)	77
Aneks 13. Objekte të financuara nga FZHR, të përfunduara 2014 - Dhjetor 2018	78
Aneks 14. Objekte të financuara nga Qeveria Shqiptare 2015-2016, të përfunduara gjatë periudhës 2017 - Dhjetor 2018	97
Aneks 15. Ndërtimi i Shëtitorës buzë Detit - Lungo Mare financuar nga IPA 2013 dhe Qeveria Shqiptare	98
Aneks 16. Objekte të financuara në kuadër të projektit "Punët në Komunitet IV", të përfunduara gjatë periudhës 2016 - Dhjetor 2018	98
Aneks 17. Objekte të financuara në kuadër të projektit "Rehabilitimi i Segmenteve Rrugore Prioritare", të përfunduara gjatë periudhës 2017 - Dhjetor 2018	100
Aneks 18. Objekte të financuara në kuadër të Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin, të përfunduara deri në Dhjetor 2018	106
Aneks 17. Projekte në zbatim Dhjetor 2018	107

PËRMBLEDHJE

Viti 2018 është shumë i rëndësishëm për Fondin Shqiptar të Zhvillimit pasi shënon rritje në aspektin e portofolit financiar që shoqërohet me rritje konceptuale të institucionit.

Me një përvojë 25 vjeçare, FSHZH mbështet Qeverinë Shqiptare për të përmbushur objektivat e saj për zhvillimin e integruar e harmonik të vendit duke përdorur të gjithë ekspertizën që ka në fushën e planifikimit dhe zbatimit të programeve rajonale në infrastrukturë, urbanizim, turizëm, bashkëpunim ndërkufitar.

Viti 2018 shënon buxhetin më të madh në historinë e institucionit. Buxheti i realizuar për vitin 2018 është rreth 125.6 milionë Euro ose sa dyfishi i buxhetit mesatar vjetor i 5 viteve të fundit. Si rrjedhojë edhe investimet e realizuara gjatë këtij viti janë 2 herë më shumë se mesatarja e investimeve për periudhën 2012 - 2017. Trendi rritës i buxhetit dhe investimeve të këtij viti, shoqërohet me stabilitet të kostos operative.

Prej korrikut 2018, Fondi Shqiptar i Zhvillimit i është nënshtruar një procesi ndryshimesh dhe ristrukturimi të brendshëm në vijim të vendimit të Këshillimit të Ministrave për të integruar Agjencitë e Zhvillimit Rajonal dhe Agjencinë për Zhvillimin Ekonomik Rajonal (AZHER) si pjesë e FSHZH. Vendimi Nr. 438, korrik 2018, synon përgatitjen e kushteve për funksionimin e reformës për zhvillimin rajonal dhe ngritjen e strukturave të afta në mbështetjen e një zhvillimi të qëndrueshëm rajonal në territor.

Tre janë drejtimet në të cilat FSHZH është angazhuar gjatë vitit 2018:

- Aplikimi i një qasjeje të re territoriale në konceptimin dhe zbatimin e projekteve. Pjesë e kësaj qasje është integrimi i AZHR-ve dhe AZHER, si pjesë e FSHZH;
- Konsolidimi i marrëdhënieve me Qeverinë Shqiptare dhe palët e tjera financuese, duke u fokusuar në plotësimin e pritshmërive të larta ndaj Fondit Shqiptar të Zhvillimit;
- Forcimi i imazhit publik të FSHZH si një institucion që udhëhiqet nga vlera themelore si profesionalizmi, përgjegjshmëria, integriteti, transparencja dhe që punon me përkushtim e seriozitet për të transformuar politikat e zhvillimit të Qeverisë në rezultate konkrete.

Gjatë vitit 2018 FSHZH ka menaxhuar 7 programe investimesh ose rreth 149 objekte të infrastrukturës dhe është duke iniciuar disa programe të reja.

Këtë volum pune FSHZH ka mundur ta përballojë falë strukturës së re organizative që ka pasur për synim përdorimin me efektivitet të burimeve njerëzore, një staf profesionistësh me përvojë dhe të përkushtuar. Si rezultat, Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka mundur të ofrojë shërbime të shpejta, fleksibël, efikase dhe me kosto të ulët. Janë realizuar sipas standardeve më të larta, projekte komplekse dhe me impakt të qënësishëm në mirëqenien e qytetarëve.

Gjatë punës së tij për zbatimin e projekteve gjatë këtij viti FSHZH ka pasur mbështetjen e plotë të Qeverisë Shqiptare dhe institucioneve financiare ndërkombëtare. Përmes financimeve të Qeverisë Shqiptare, Bankës Botërore, KfW, Bankës së Këshillit të Europës për Zhvillim, Fondit Kuvajtian, Fondit Saudit, etj, po

mundësohen investime të rëndësishme në të gjithë vendin dhe me impakt të drejtpërdrejtë në jetën e banorëve. Janë më shumë se 1 milion banorë në të gjithë vendin të cilët kanë përfituar drejtpërdrejt nga investimet e FSHZH gjatë vitit 2018.

Koordinimi shumë i mirë dhe bashkëpunimi konstant dhe transparent me partnerët në nivel qendror dhe lokal konsiderohet një nga çelësat e suksesit të institucionit në performancën e këtij viti.

Në të gjitha misionet e zhvilluara gjatë këtij viti, donatorët kanë shprehur vlerësim maksimal për aktivitetin e FSHZH dhe si rrjedhojë janë hapur perspektiva të reja bashkëpunimi për financimin e projekteve zhvillimore në të ardhmen e afërt.

Në këtë raport paraqiten drejtimet kryesore të punës së FSHZH gjatë vitit 2018:

- Menaxhimi financiar;
- Ecuria e projekteve në zbatim;
- Përgatitja e projekteve të reja për financim;

Projekte aktuale

Gjatë vitit 2018, investimet e kryera nga Qeveria Shqiptare në kuadër të **Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, Projektit për Rehabilitimin e Segmenteve Rrugore Prioritare, dhe Projektit të Investimeve Prioritare me impakt të lartë në zhvillimin dhe promovimin e turizmit**, zënë peshën më të madhe të investimeve të kryera nga FSHZH me rreth 90 % të buxhetit të realizuar. Ecuria e investimeve fizike ka qenë e kënaqshme dhe në fund të kësaj periudhe, rezultoi se punimet civile kanë përfunduar në pjesën më të madhe të objekteve¹.

Rreth 55 milionë Euro janë akorduar nga Qeveria Shqiptare në kuadër të FZHR-së, të cilat janë transferuar përmes Ministrisë së Financave në institucionet vendore dhe qendrore për financimin e projekteve në vazhdim të investimeve në kuadër të Programit Infrastruktura Vendore dhe Rajonale.

Rreth 36 milionë Euro janë akorduar këtë vit nga Qeveria Shqiptare për **Rehabilitimin e Segmenteve Rrugore Prioritare**² dhe **Investimeve Prioritare me impakt të lartë në zhvillimin dhe promovimin turizmit**, në të gjithë vendin.

Projekti për Rehabilitimin e Segmenteve Rrugore Prioritare ka nisur në fillim të vitit 2017 dhe parashikon ndërtimin e 180 kilometrave rrugë për një periudhë trevjeçare. Këto investime mundësojnë lidhjen me rrugë të standardeve europiane të dy ose më shumë rajoneve me njëri-tjetrin, duke përmirësuar lëvizjen në qendrat urbane përmes unazave të qyteteve dhe rrugëve hyrëse. Ecuria është kënaqshme dhe realizimi fizik i punimeve ka arritur në rreth 95 përqind. Punimet civile kanë përfunduar në 16 segmente rrugore dhe pjesa tjetër e rrugëve parashikohet të përfundojë gjatë të vitit 2019.

Projekti i Investimeve Prioritare me impakt të lartë në zhvillimin dhe promovimin turizmit, filloi zbatimin në fillim të këtij viti. Financimi i tij erdhi si rezultat i ecurisë pozitive dhe performancës së lartë në menaxhim e objekteve të financuara nga Qeveria Shqiptare. Në një periudhë të shkurtër kohore FSHZH, arriti të përzgjedhë, plotësojë dhe standartizojë projektet e zbatimit për objektet që do të financohen. Aktualisht punimet kanë përfunduar në Rrugën Kryqëzimi Shëngjin -

¹ Aneks 1. Lista e plotë e objekteve të Fondit Shqiptar të Zhvillimit me financim të FZHR-së (Dhjetor 2018)

² Aneks 2. Lista e segmenteve rrugore që financohen në kuadër të Projektit për Rehabilitimin e Segmenteve Rrugore Prioritare 2017-2019 (Dhjetor 2018)

qyteti Shëngjin - Porti Ushtarak dhe vijon puna puna në 13 objekte, si Bulevardi i Vlorës, Sheshi i Shirokës, Rehabilitimi i Lumit Gjanica dhe rikonceptimin e qendrës së qytetit të Fierit, etj. Në fazën e kontraktimit është 1 objekt dhe në fazën e tenderim vlerësimit janë 7 objekte. Pritet që në muajt në vijim të finalizohet procesi i tenderimit për objektet e tjera.

Punë intensive është zhvilluar edhe për zbatimin e programit **për Zhvillimin e Alpeve Shqiptare dhe Zonës Bregdetare të vendit**, i cili mbështetet financiarisht nga CEB dhe Qeveria Shqiptare. Në kuadër të zbatimit të këtij projekti gjatë vitit 2018, ka vijuar puna për përgatitjen e procedurave të tenderimit, kontraktimit dhe zbatimit të punimeve civile për 16 kontrata punimesh civile në Vlorë, Himarë, Gjirokastrë, Ulëz, Pukë, Valbonë, Tamarë, Vermosh.³

Aktualisht kanë përfunduar punimet civile për fazën e parë të Rikualifikimit Urban në Bashkinë Vlorë, Restaurimin e fasadave dhe rikualifikimin e qendrës Gjirokastrë, Rikonstruksionin e rrugës së Kaninës, Rikualifikimi urban në Bashkinë Pukë, Rruga Port - Pylli i Sodës dhe Rikonstruksioni i rrugës së Ulzës. Ndërkohë vijon puna në 9 objekte të tjera infrastrukturore dhe janë në fazën e përgatitjes së dokumentacionit edhe kontrata të tjera në zonën e Alpeve. Hartimi i masterplanit të Alpeve gjatë vitit 2017, mes të tjerash shërben si bazë për identifikimin e ndërhyrjeve prioritare në këtë zonë. Plani Kombëtar Sektorial i Turizmit për Alpet shqiptare së bashku me studimin për kërkesën turistike, programin e investimeve për infrastrukturën vendore dhe strategjinë e marketingut turistik përbëjnë Masterplanin e Alpeve.

Rruga e Lumit të Vlorës, Gjatë vitit 2017, është lidhur kontrata e punimeve për Lot-in e parë dhe ecuria është e kënaqshme. Punimet janë realizuar në masën 80 përqind.

Janë në proces tenderimi loti i dytë dhe i tretë i rrugës, Ura e Gjormit - Brataj - Ura e Laskos dhe Ura e Laskos - Qeparo. Aktualisht është shpallur fituesi për kontratat e punimeve civile Lot II , Lot III. Parashikohet që kontrata e punimeve për Lotet II & III, të lidhet në Shkurt 2019.

Për Lot IV, është lidhur kontrata me supëvizionin. Kontrata e supëvizionit të punimeve parashikon rishikimin e projektit dhe preventivin, duke bërë përmirësimet e nevojshme në përshtatje me kushtet në terren. Aktualisht supëvizori është duke punuar me rishikimin e projektit, i cili do t'i hapë rrugë nisjes së procedurave për tenderimin e punimeve civile. Rishikim i projektit parashikohet të zgjasë rreth 3 muaj.

Është aprovuar nga Fondi Kuvajtjan për Zhvillim Arab një grant për Asistencë teknike, me vlerë rreth 700 mijë USD dollarë. Granti do të përdoret për të përgatitur studime fizibiliteti për projekte infrastrukturore për zhvillimin e bregdetit të jugut. Në përfundim të këtij studimi do të gjenerohen projekte në shumën rreth 30 milionë dollarë, të cilat mund të paraqiten në donatorë të mundshëm për t'u financuar. Aktualisht janë përgatitur termat e references dhe pritët miratimi nga donatori për të vijuar me prokurimin.

Projekti për Zhvillim të Integruar Urban dhe Turistik u bë zyrtarisht efektiv në fund të prillit 2017 dhe do të ketë një kohëzgjatje 5-vjeçare deri në Korrik të vitit 2022. Ai financohet nga Banka Botërore në vlerën 63.8 milionë Euro (me TVSH), dhe shtrihet në qendrat urbane të Sarandës, Gjirokastrës, Beratit, Përmetit si dhe përgjatë korridorit turistik që kalon në këtë rajon.

Aktualisht kanë përfunduar punimet për 2 objekte: Ndriçimin e rrugës hyrëse në Përmet dhe Rehabilitimin e rrugës këmbësore për në Kalanë e Beratit dhe pikës

Aneks 5. Informacion mbi nënprojektet e programit "Punët në Komunitet IV", financuar nga CEB, Qeveria Shqiptare dhe NJQV-të përfituese (Dhjetor 2018)

panoramike jugore të Kalasë së Beratit "Tabja". Njëkohësisht është kryer dorëzimi i pajisjeve teknologjike për Stacionin e Transferimit të Mbetjeve në Himarë. Ndërkohë vijon puna për zbatimin e objekteve të tjera dhe përgatitjen e projekteve teknike dhe dokumentacionit për tenderimin e punimeve punimeve civile.

Programi i Rrugëve Lidhëse Rajonale, parashikon ndërhyrje në rrjetin rrugor rajonal në zona me potencial bujqësor dhe turistik në të gjithë vendin. Ai bashkëfinancohet nga Banka Botërore dhe BERZH me vlerë të pritshme financimi rreth 100 milionë USD. Projekti është bërë efektiv gjatë vitit 2018 dhe do të ketë kohëzgjatje 5 vjeçare. Pjesë e fazës së parë të financimit nga Banka Botërore do të jenë segmentet rrugore Fier-Seman, Qafë Thore -Theth dhe Pogradec - Tushemisht.

Projekti "Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III", parashikon ndërhyrje në shkallë të gjerë në të gjithë vendin. Në këtë kuadër u ngrit një skemë e tërë aplikimesh ku u ftuan të merrnin pjesë gjitha bashkitë e vendit. Aktualisht ka përfunduar përgatitja e fizibiliteteve teknike, sociale dhe mjedisore për 30 skema, nga të cilat 19 prej tyre kanë rezultuar fizibël. KfW ka dhënë miratimin për 18 skemat e para dhe pritet miratimi edhe i disa skemave të tjera shtesë. 18 nga skemat e miratuara kanë përfunduar fazën e projektimit gjatë vitit 2018, dhe pjesërisht janë tenderuar ose janë në proces tenderimi.

Puna në terren për ndërtimin e ujësjellësave do të organizohet në Lot-e dhe parashikohet të fillojë gjatë muajit Shkurt 2019 me Lot I.

FSHZH gjatë vitit 2018 ka filluar zbatimin e **10 projekteve të financuara nga Programet CBC/Bashkëpunimit Ndërkufitar**. Projektet në total kanë një vlerë rreth 1.5 Milion Euro.

Programe të reja

Programi Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale IV, i cili parashikon ndërhyrje të plota në të gjithë sistemin e furnizimit me ujë dhe atë të ujërave të zeza, ndërtimin e një impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Bashkinë Himarë dhe qytetin e Orikumit. Ai do të financohet nga KfW, WBIF, Qeveria Shqiptare, me vlerë të pritshme financimi 53 milionë Euro. Projekti parashikohet të bëhet efektiv gjatë të vitit 2019, përmes nënshkrimit të Marrëveshjes së Kredisë dhe do të ketë kohëzgjatje 5 vjeçare.

Programi për Zhvillimin e Integruar të Zonave me Potencial Turistik, parashikon investime strategjike rajonale në zonat me potencial turistik në Bashkinë e Shkodrës, Korçës, Fier, Berat. Projekti do të financohet nga BERZH dhe IPA me vlerë të pritshme financimi 100 milionë Euro. Ky projekt është në fazë programimi dhe parashikohet të ketë kohëzgjatje 4 vjeçare.

Projekti Porta e Alpeve

Projekti në vlerën 2.5 milion Euro, fokusohet në bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe dhe Lezhë dhe specifikisht në zonën liqenore të Liqenit të Shkodrës, në fashën lumore të Bunës si dhe në bregdetin Adriatik të Velipojës dhe Shëngjinit.

Projekti përfshin zonat urbane por gjithashtu edhe zonat natyrore dhe mjedisore të këtyre bashkive. Projekti "Gate of Alps" ka dy komponentë kryesorë: atë të studimit të integruar urban dhe turistik të zonës si dhe përgatitjen e projekteve teknike specifike për zonën.

"Programi i investimeve për zhvillim të integruar rajonal", i cili parashikon ndërhyrje infrastrukturore të integruara në funksion të nxitjes së zhvillimit ekonomik të zonave me potencial turistik. Programi bashkëfinancohet nga Qeveria Gjermane, dhe parashikohet që në fazën e parë të financohet përmes një kredie të butë të KfW deri

në 20 milionë euro dhe bashkëfinancim nga Qeveria Shqiptare për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikqyrjen e projektit në vlerë deri në 1 milion euro.

Projekti ALMONIT-MTC (Albania, Montenegro, Italy - Multimodal Transport Connectivity), parashikon krijimin e një rrjeti lëvizjeje ndërmjet shteteve pjesëmarrëse, përkatësisht Shqipëria, Mali i Zi dhe rajonet e Puglias dhe të Molises, Itali. Përmes krijimit të transportit multimodal, ku përfshihet krijimi i linjave të reja detare dhe zhvillimi i Liqenit të Shkodrës, pritet të rritet jo vetëm lidhshmëria, por edhe ndërveprimi ndërmjet vendeve të Adriatikut të ulët. Projekti parashikohet të ketë një financim prej rreth 3 milionë Euro dhe kohëzgjatje 4 vjeçare.

Buxheti i miratuar për vitin 2018 për institucionin është rreth 132.5 milionë Euro. Gjatë vitit 2018 realizimi është në masën 95 % ose rreth 125.6 milionë Euro⁴. Investimet gjatë kësaj periudhe janë realizuar në masën 96 % të buxhetit të miratuar, ose rreth 118.8 milionë Euro.

Përgjithësisht ka ecuri të mirë të projekteve në proces zbatimi, të cilat kanë nivel të kënaqshëm të realizimit të investimeve.


Gjatë këtij viti, ka vijuar informimi publik përmes mediave vizive dhe atyre të shkruara, nëpërmjet së cilave është siguruar dhe njohja e gjerë e publikut me rezultatet e punës së FSHZH-së, si dhe aktivitetet në vijim.

Vlen për t'u theksuar se ka vijuar bashkëpunimi intensiv dhe i suksesshëm me ministritë e linjës dhe agjensitë shtetërore.

⁴ Aneks 10. Realizimi i zërave të buxhetit për vitin 2018 (sipas Donatorëve - Euro)

Paraqitja e projekteve sipas donatorëve dhe statusit të tyre Dhjetor 2018

Programi	Donatori	Totali	Projekte në fazën e përgatitjes së dokumentacionit	Në tenderim / vlerësim	Në kontraktim	Në zbatim	Projekte të përfunduara Në Garanci	Mbyllur / Dorëzuar
Qeveria Shqiptare 2014 - 2015 (FZHR)	QSH	38				1	22	15
Qeveria Shqiptare investime 2016	QSH	3				1	2	
Rehabilitimi i segmenteve rrugore prioritare Qeveria Shqiptare 2017-2019	QSH	24				8	16	
Projekti i Investimeve Prioritare me impakt të lartë në zhvillimin dhe promovimin turizmit Qeveria Shqiptare 2018-2019	QSH	27	4	8	2	12	1	
Punët në Komunitet IV	CEB	16	1		1	9	4	1
Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës	FK & FS	4	1	2		1		
Projekti për Zhvillimin e Integruar dhe Turizmin	BB	18	3		1	12 ⁵	2	
Projekti i Rrugëve Lidhëse Rajonale	BB	3	2	1				
Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III	KfW, IPA 2013, GoA	18	5	10	3			
Lungomare	IPA 2013	1					1	
TOTALI		152	16	21	7	44	48	16



⁵ Këtu përfshihen objekte infrastrukturore dhe kontrata konsulence për projekte zhvillimore.

1. Programi i investimeve të Qeverisë Shqiptare

Programi investimeve të Qeverisë Shqiptare zë pjesën më të madhe të buxhetit të FSHZH për vitin 2018.

Programi ka për objektiv përmirësimin e kushteve të jetesës të banorëve në të gjithë vendin, rritjen e aksesit në shëbimet bazë, promovimi i turizmit dhe nxitja e sektorit bujqësor, përmes financimit të projekteve të mëdha me ndikim rajonal. Investimet janë në perputhje të plotë me vizionin e Qeverisë Shqiptare për transformimin urban të qendrave të qyteteve, infrastrukturës rrugore dhe furnizimit me ujë.

Ai përfshin projekte zhvillimore të fokusuara kryesisht në:

- Infrastrukturë rrugore dhe urbane;
- Furnizim me ujë të pijshëm dhe kanalizime;
- Mjedis;
- Rikonstrukcion i shkollave;
- Projekte studimore, hapësinore, të trashëgimisë kulturore, etj;
- Hartim i projekteve teknike të gatshme për financim për Njësitë e Qeverisjes Vendore;

Investimet e kryera nga Qeveria Shqiptare në kuadër të Projektit për Rehabilitimin e Segmenteve Rrugore Prioritare, Projektit të Investimeve Prioritare me impakt të lartë në zhvillimin dhe promovimin e turizmit, dhe Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, zënë peshën më të madhe të investimeve të realizuara këtë vit nga FSHZH me rreth 90 % të buxhetit të realizuar.

1.1 Projekti i Rehabilitimit të Segmenteve Rrugore Prioritare

Gjatë vitit 2016, FSHZH në vijim të diskutimeve me Qeverinë Shqiptare ndërmori procesin e identifikimit dhe vlerësimit të segmenteve rrugore prioritare me impakt të lartë në zhvillimin ekonomik me objektiv përmirësimin e infrastrukturës rrugore.

Me qëllim identifikimin e segmenteve rrugore prioritare me impakt të lartë në zhvillimin ekonomik të vendit dhe detajimin e një liste investimesh prioritare për periudhën 2017 - 2019, u analizuan kërkesat që kanë ardhur pranë FSHZH-së dhe FZHR-së nga bashkitë, qarqet, përfaqësuesit e mandatuar të komuniteteve, databaza për rrugët që ka ngritur FSHZH në kuadër të Programit të “Rrugëve Dytësore dhe Lokale”, financuar nga donatorë të ndryshëm (IDA, CEB, OPEC, IDB, KfW, BERZH, BEI, IPA 2009/10/11) si dhe verifikimet në terren nga inxhinierët e FSHZH-së në segmentet rrugore prioritare dhe plotësimi i skedave individuale.

Pas hartimit të listës paraprake të investimeve, procesi vijoi me përcaktimin e segmenteve prioritare, bazuar në numrin e përfituesve, shkallën e degradimit të rrugës, rëndësinë e qarkullimit të mjeteve në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, akse rrugore të gatshme dhe pa probleme pronësie, kosto paraprake investimi, lidhja me një rrugë tjetër në gjendje të mirë.

Kjo listë përmban 20 segmente rrugore me vlerë të përafërt rreth 9.5 miliardë lekë, si:

- Cërrik - Belsh - Kuçovë - Ura Vajgurore;
- Harku i Bërdicës - Kryqëzimi Baks,
- Unaza Pogradec - Qafë Pllaçë,
- Unaza e Peshkopisë,
- Fushë Arrëz - Rreps (Rruga e Kombit),
- Fushë Krujë - Thumanë (aksi i vjetër),
- Shëtitorja në Golem (Mak Albania),
- Hyrja e Bajram Currit,
- Hyrjet e Rrogozhinës, etj.

Pas miratimit në Këshillin Drejtues dhe Ministrinë e Financave, u krye një punë intensive për plotësimin dhe standartizimin e projekteve teknike dhe shpalljen e procedurave të prokurimit.

Për vetë specifikën dhe rëndësinë e tyre akset, Cërrik-Belsh-Kuçovë-Ura Vajgurore dhe segmenti Harku i Bërdices - Baks, janë ndarë me nga tre lote.

Gjatë vitit 2017, puna filloi në të gjitha segmentet rrugore dhe ecuria ka qënë e kënaqshme.

Realizimi fizik i punimeve në terren deri në fund të vitit 2018 është në masën 95%.

Punimet kanë përfunduar në 16 segmente rrugore:

- Grekan - Dragot, pjesë aksit Cërrik - Belsh - Kuçovë - Ura Vajgurore;
- Fushë Arrëz - Reps;
- Rikonstruksioni i 3 rrugëve hyrëse të qytetit të Rrogozhinës;
- Gradishtë - Spolatë;
- Mërtish - Tre Urat;
- Rikonstruksioni i rrugës hyrëse të qytetit Bajram Curri;
- Unaza e Vaut të Dejës;
- Rruga Taulantët në Universitetin Bujqësor të Tiranës;
- Rruga Gërmenj - Okshtun - Zambishtë;
- Rikonstruksioni i rrugës Ura e Çopanit - Zhabiak - Ura e Çorumit;
- Lalëz - Bizë - Draç;
- Rikonstruksioni i rrugëve 2,3,4 dhe paralele në Golem;
- Rikonstruksioni i rrugës Kastriot - Arras;
- Sistemim, asfaltim rruga Qafë Plloçë - Pogradec dhe Unaza Pogradec;
- Rikonstruksioni i rrugës Korçë - Voskop - Polenë - Korçë;
- Rikonstruksioni i rrugës Borje - Kufi;

Në segmentet e tjera parashikohet që punimet të përfundojnë gjatë vitit 2019.

***Aneks 2.** Lista e segmenteve rrugore që financohen në kuadër të Projektit për Rehabilitimin e Segmenteve Rrugore Prioritare 2017-2019 (Dhjetor 2018)*

1.2 Projekti i Investimeve Prioritare me impakt të lartë në zhvillimin dhe promovimin e turizmit, 2018 - 2019

Si rezultat i ecurisë pozitive dhe performancës së lartë në menaxhimin me sukses të objekteve të financuara në vitin 2017, Fondi Shqiptar i Zhvillimit vazhdoi procesin e identifikimit dhe seleksionit të projekteve të tjera me impakt të lartë në zhvillimin dhe promovimin e turizmit. Për këtë projekt Qeveria Shqiptare ka akorduar një financim prej rreth 7.2 miliardë Lekë.

Aktualisht kanë përfunduar punimet për:

- Asfaltimin e rrugës Kryqëzimi Shëngjin - qyteti Shëngjin - Porti Ushtarak;

Ndërkohë ka nisur dhe vijon puna për objektet :

- Bulevardi i Vlorës;
- Rikonstruksioni i sheshit të Shirokës;
- Rikonstruksioni i rrugëve të brendshme dhe rikualifikimi i hapësirave publike tek zona e plazhit të Shkëmbi i Kavajës;
- Ndërtimi i stacionit të pompimit, Depos 50m³ dhe rrjetit elektrik TU dhe TM për furnizimin e depos 2,000 m³ të Lugut të Dardhës, Sarandë;
- Rruga Qendër Gosë - Hekurudha - Gosë e Madhe, Bashkia Rrogozhinë;

- Rehabilitimi i Lumit Gjanica dhe rikonceptimi i qendrës së qytetit të Fierit;
- Rikonstruksioni/rikualifikimi urban pranë qendrës së qytetit Vlorë, Zona B drejtim i rrugës Justin Godart;
- Rikonstruksioni i Rrugës Ramize Gjebrea Faza 2 (Lidhja e rrugës së Pyllit të Sodës me rrugën Transballkanike dhe Autostradën);
- Rikonstruksioni i rruges Agim - Babunje, Bashkia Divjakë;
- Rikonstruksioni i rrugës së Beratit (Segmenti Ish Fabrika Plasmasit - Karbunarë);
- Ndërtimi i sheshit të Roskovecit;
- Rikonstruksioni i Unazës Bujqësore të Myzeqesë: Segmentet Rrethrotullim Imësht - Ngurrëz, Fier i Ri - Kashtbardh, Qerret - Kadiaj - Savër;
- Tepelenë - Bençë - Lekdush punime shtesë;

Në proces kontraktimi:

- Rikualifikim i Parkut Industrial Kuçovë;

Janë në proces tenderim vlerësimi:

- Ndërtimi i Pedonales dhe Korsisë së B biçikletave te Liqeni Belshit, Faza III;
- Ndërtim i Urës Zezë dhe mbrojtje nga përmytjet qyteti Fushë-Krujë;
- Rikonstruksioni i Shëtitorës Taulantia, Durrës;
- Rikonstruksioni i rruges Balldre - Bend;
- Rivitalizim urban, Bulevardi Maliq - Drithas;
- Rikonstruksioni i rrugës aksi Nacional Luftinjë (Faza e Parë - Rruga e Izvorit), Njësia Administrative Luftinjë;
- Projektim i rikualifikimit urban pranë Qendrës së qytetit Vlorë"Zona A drejtimi i Kullës së Sahatit;

Ka përfunduar procedura e prokurimit dhe është në fazën e lidhjes së kontratës Projektim i Zonës së Plazhit Durrës.

Për objektet e tjera, po punohet me plotësimin dhe standartizimin e projekteve të zbatimit.

***Aneks 3.** Lista e objekteve të financuara nga Qeveria Shqiptare në kuadër të Projektit të Investimeve Prioritare me impakt të lartë në zhvillimin dhe promovimin e turizmit 2018 - 2019 (Dhjetor 2018)*

1.3 Investime të Qeverisë Shqiptare 2015 - 2016

Gjatë vitit 2016, Qeveria Shqiptare ka financuar 2 segmente rrugore në qarkun Gjirokastrë për rikonstruksionin e rrugëve Autostradë - Fshati Bulo dhe Tepelenë - Bençë - Lekdush, dhe ndërtimin e ujësjellësit Çermë - Tërbuf - Sulzotaj në qarkun Fier. Puna për përgatitjen e dokumentacionit dhe projekteve teknike ka nisur që në vitin 2015 dhe është finalizuar në vitin 2016 me lidhjen e kontratave për fillimin e punimeve civile.

Në shkurt 2017, kanë përfunduar punimet për rikonstruksionin e rrugës Autostradë - fshati Bulo dhe në Maj 2018 kanë përfunduar punimet për ndërtimin e ujësjellësit Çermë - Tërbuf - Sulzotaj.

Ndërkohë janë drejt përfundimit punimet për rrugën Tepelenë - Bençë - Lekdush. Parashikohet që punimet civile për këtë objekt të mbyllet në fund të vitit 2018.

***Aneks 4.** Lista e objekte të financuara nga Qeveria Shqiptare 2015-2016 (Dhjetor 2018)*

1.4 Bashkëpunimi i FSHZH me Fondin e Zhvillimit të Rajoneve në kuadër të Projekteve të Infrastrukturës Vendore

Fondi i Zhvillimit të Rajoneve ka shënuar një transformim të rëndësishëm, nga një instrument financimi i projekteve të vogla me impakt të kufizuar, drejt financimit të projekteve më të mëdha me ndikim rajonal, në funksion të vizionit të transformimeve urbane të qendrave të qyteteve të mëdha.

Duke vlerësuar kapacitetet dhe performancën e lartë të FSHZH-së, për periudhën 2014 - 2016, Qeveria Shqiptare i ka akorduar zbatimin e 58 objekteve të ndryshme infrastrukturore dhe 6 projekte studimore me një vlerë totale prej rreth 8.18 miliardë Lekë. 57 objekte infrastrukturore kanë përfunduar dhe kanë kaluar në periudhë garancie. Pjesa më e madhe tyre janë mbyllur përfundimisht gjatë periudhës 2017 - 2018 dhe u kanë kaluar njësitve të qeverisjes vendore përfituese për t'i vënë në shfrytëzim të komuniteteve të tyre. Në 1 objekt tjetër punimet janë në proces dhe pritet të mbyllet gjatë vitit 2019.

1.4.1 Zbatimi i projekteve të akorduara nga FZHR për periudhën 2014 - 2016

Fondi Shqiptar i Zhvillimit gjatë periudhës 2014 - 2016 ka përfituar nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve një fond investimesh në një vlerë totale prej rreth 8.18 miliardë Lekë. Këto financime janë të fokusuar në disa drejtime prioritare:

- (i) 39 projekte për përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe asaj urbane, (Hyrjet e Tiranës nga Durrësi dhe Elbasani, Sistemimi i 2 shesheve në Tiranë, Unaza e Divjakës, Rruga Transballkanike në Vlorë, Mbushja me rërë e plazhit Vlorë, Rruga Dhimitër Konomi Vlorë, Rruga e Dajtit, Sheshi i Kukësit, Shëtitorja Himarë, etj.);
- (ii) 5 projekte të furnizimit me ujë (ujësjellësat në Sarandë, Dhërmi, Ksamili);
- (iii) 10 projekte mjedisore dhe gjelbërimi (Pyllëzimi i Krastës në Krujë, Gjelbërimi i aksit rrugor Plepa - Vlorë, Gjelbërimi i vijës bregdetare të Vlorës dhe Parkut të Liqenit Artificial në Tiranë; Gjelbërimi i aksit Levan - Kakavijë, Lushnje - Berat, Gjelbërimi i aksit IKV - Surrel, dhe Segmentit Lin - Pogradec, etj.);
- (iv) 4 projekte arsimore përmes të cilave u mundësua rikonstrukcioni i disa shkollave, si: Shkolla e mesme e bashkuar Tunjë, Gramsh; Shkolla 9-vjeçare në fshatin Sheq të Frakullës; Shkolla 9-vjeçare në Toshkëz, NjA Allkaj; Shkolla 9-vjeçare Dërsnik, NjA Voskop;
- (v) 6 projekte studimore, trashëgimi kulturore dhe të dhëna gjeohapësinore (përgatitja e projektit teknik për Lungomaren, Restaurimi dhe Muzealizimi i Fototekës Marubi, projekti i krijimit të të dhënave gjeohapësinore për mbështetjen e zhvillimit rajonal, përgatitjes së projekteve për vitin 2015 - 2016, Hartimin e studimeve dhe projekt-ideve për projektet urbane, ku përfshihen realizimi i masterplanit të Qytetit Studenti, masterplani i Parkut të Liqenit Artificial, projekt-ideja për Ishullin e Osumit, supervizioni estetik i Lungomares, etj.

Projektet e infrastrukturës rrugore dhe urbane. Punimet kanë përfunduar në të gjitha objektet.

Projektet e furnizimit me ujë në zonën e Bregdetit të Jugut. Punimet kanë përfunduar në të gjitha skemat e ujësjellësave. Ujësjellësat kanë përfunduar periudhën e garancisë dhe u janë dorëzuar bashkive përfituese.

Projektet mjedisore. Punimet e mbjelljes së pemëve kanë përfunduar në 9 objekte, të cilat janë mbyllur përfundimisht.

Projektet e rikonstruksionit të shkollave. Punimet kanë përfunduar në të gjitha shkollat. Objektet kanë periudhën e garancisë së defekteve dhe u janë dorëzuar për administrim bashkive përfituese.

Projektet studimore, hapësinore, të trashëgimisë kulturore, etj. Në kuadër të këtyre projekteve vlen të përmendet angazhimi i FSHZH-së në përgatitjen e disa projekteve të rëndësishme si përgatitja e projektit teknik të fazës së dytë të Lungomares, përgatitja e projektit bashkëkohor për restaurimin dhe muzealizimin e Fototekës Marubi, krijimi i sistemit të të dhënave gjeohapësinore për mbështetjen e zhvillimit dhe menaxhimit rajonal, hartimin e projekteve për zonën Tiranë - Durrës dhe Bregdetin e Jugut, përgatitja e projekteve të zhvillimit të zonave urbane, si dhe përgatitja e disa Master Planeve si ai i qytetit Studenti, i Parkut Sportiv në Korçë, i Parkut të Liqenit Artificial, projekti i rikonstruksionit e ndryshimit të destinacionit të ish-laboratorit hidraulik në Qendër Arti, etj.

1.4.2 Studime, Projekttime dhe Mbikqyrje për Fondin e Zhvillimit të Rajoneve 2016

Gjatë vitit 2015, Qeveria Shqiptare nëpërmjet Fondit të Zhvillimit të Rajoneve miratoi një fond i cili bashkëfinancon përgatitjen dhe hartimin e projekteve teknike për infrastrukturën vendore për periudhën 2016-2017. Qëllimi i këtij fondi ishte përgatitja në kohë dhe me cilësi të projekteve teknike të gatshme për financim nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.

Në këtë kuadër studio projektimi, (që kanë në stafin e tyre arkitektë me eksperiencë ndërkombëtare), u angazhuan për hartimin sipas nevojës të projekt-ideve dhe projekteve të plota të zbatimit për zhvillimin e territorit të bashkive përkatëse.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit ftoi 12 bashkitë qendër qarku për të marrë pjesë në procesin e konkurimit për përzgjedhjen e 6 bashkive.

Nga ky proces u përzgjedhën Bashkitë Tiranë, Durrës, Vlorë, Korçë, Shkodër dhe Berat. Gjatë vitit 2017 u përgatitën projekt-idete dhe projekt e zbatimit për bashkitë pjesëmarrëse. Në fund të këtij procesi u realizua hartimi i projekteve teknike për 20 projekte prioritare.

Për Bashkinë Tiranë është dorëzuar projekt-zbatimi për “Rikualifikimin urban të Sheshit Skënderbej dhe Parkimin nëntokësor”. Ky projekt ka përfunduar punimet civile në Qershor 2017.

Për Bashkinë Durrës janë dorëzuar projekt-zbatimet për projektet:

- Shëtitorja bregdetare përgjatë plazhit tek “Shkëmbi i Kavajës si dhe lidhja e saj me monumentin historik natyror (landmark) - Shkëmbi i Kavajës” ;
- Itinerar i ri turistik në zonën historike të qytetit të Durrësit (Amfiteatër - Fari) ;
- Porta e Jallisë - Hamami ;
- Rikonceptimin dhe rikonstruksionin e Shkollës së Muzikës “Jan Kukuzeli”;
- Rikonceptimin dhe rikonstrukionin e Qendrës Kulturore të Fëmijëve Durrës;
- Rindërtimin e shkollës 9-vjeçare “Jusuf Puka”;
- Rivitalizimi i tregut fruta perime ;

Për Bashkinë Vlorë, janë dorëzuar projekt-zbatimet për projektet:

- Rikualifikimi i Bulevardit kryesor Ismail Qemali, në qytetin e Vlorës
- Rivitalizimi i zonave në të dyja anët e rrugës Transballkanike.

Për Bashkinë Korçë, është dorëzuar projekt-zbatimi për projektet:

- Qendra polifunksionale kreative”,
- Ndërtimi i Parkut Japonez & Kopshtet e Komunitetit

- Rikonstruksioni i muzeut të fotografise Gjon Mili;
- Kubi i Muzeut të fotografisë Gjon Mili;
- Rehabilitimi urban e lulishtes Lëndina e loteve;
- Rehabilitimi urban i parkut “Vangjush Mio”;
- Ndërtimi i muzeut të kohëve të harruara;

Për Bashkinë Shkodër, është dorëzuar projekt-zbatimi për projektin:

- Rikualifikimi i bregut perëndimor të Liqenit të Shkodrës.

Për Bashkinë Berat, është dorëzuar projekt-zbatimi për projektin:

- Qendra sportive argëtuese për fëmijë në qytetin e Beratit.

Të gjitha projektet teknike u janë dorëzuar bashkive respektive dhe pjesa më e madhe e tyre kanë përfunduar punimet civile ose janë në proces zbatimi. Për pjesën tjetër pritet që puna të fillojë së shpejti.

Për të gjitha projektet janë plotësuar dosjet me projektin, preventivin dhe gjithë dokumentacioni përkatës.

1.4.3 Transferimi fondeve nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për financimin e projekteve në vazhdim të investimeve në kuadër të Programit Infrastruktura Vendore dhe Rajonale, FZHR.

Transferimi i fondeve nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për financimin e projekteve në vazhdim të investimeve në kuadër të Programit Infrastruktura Vendore dhe Rajonale, përfshin rreth 7,2 miliardë Lekë investime në kuadër të FZHR-së. Këto investime menaxhohen nga Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe institucione qendrore. Fondi Shqiptar i Zhvillimit në rolin e sekretariatit teknik për Programin e Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, monitoron, financimin dhe zbatimin e programit duke siguruar mbarëvajtjen e tij.

Aneks 1. Lista e plotë e objekteve të Fondit Shqiptar të Zhvillimit me financim të FZHR-së (Dhjetor 2018)

Prokurimi

Procedurat e prokurimit për financimet nga Qeveria Shqiptare janë kryer në përputhje me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar dhe akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtaritë përkatëse.

2. Programi Punët në Komunitet IV “Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonës Bregdetare”

Objektivi i projektit “Punët në Komunitet IV - Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonës Bregdetare” është nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm social-ekonomik në komunitetet me potencial të lartë turistik, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës së integruar publike duke respektuar mjedisin dhe ruajtur trashëgiminë kulturore dhe historike.

Komponentët e projektit janë:

- investime në infrastrukturë dhe shërbimet lokale publike (rikualifikim urban e rrugë, ujësjellës-kanalizime, menaxhim i mbetjeve urbane, etj);
- asistencë teknike & ngritje kapacitetesh (studime fizibiliteti, përgatitje strategjish lokale, hartim projektesh, trajnime).

Projekti me vlerë 36.7 milionë Euro bashkëfinancohet nga Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës (CEB), Qeveria Shqiptare dhe NJQV-të përfituese, WBIF.

Burimet e financimit përfshijnë 28.7 milionë euro kredi nga CEB, 1 milion Euro grant nga CEB Social Dividend Account (SDA), një kontribut 6 milionë Euro nga Qeveria e Shqipërisë dhe NJQV përfituese, si dhe një 1 milion Euro grant nga WBIF. Parashikohet që dy të tretat e kostos së Programit të investohen në zonën bregdetare të Jugut dhe një e treta në zonën e Alpeve Shqiptare.

Marrëveshja e financimit midis Qeverisë Shqiptare dhe CEB për këtë projekt është firmosur në datë 21 Maj 2015 dhe është ratifikuar nga Parlamenti në datë 2 Korrik 2015. Projekti ka filluar nga puna në gjashtëmuorin e dytë të vitit 2015 dhe duhet të përfundojë në shtator 2019. Duke marrë në konsideratë problematikat sociale të hasura gjatë zbatimit të projektit në zonën bregdetare të Jugut, data e përfundimit të projektit mund të shtyhet me 1 vit.

Përsa i përket komponentit të investimeve në infrastrukturë, kanë përfunduar punimet civile për:

- Rikualifikimin urban në Bashkinë Vlorë, faza e parë;
- Restaurimin e fasadave dhe rikualifikimin e qendrës Gjirokastër;
- Rikonstruksionin e rrugës së Kaninës;
- Rikonstruksionin e rrugës së Ulzës;
- Rikonstruksionin e rrugës Port - Pylli i Sodës;
- Rikualifikimin urban dhe mjedisor të qendrës dhe liqenit të Pukës;

Ndërkohë vijon puna për zbatimin e punimeve civile në terren për:

- Rikonstruksionin e Bulevardit ‘Ismail Qemali’, Faza I;
- Rikualifikimin urban në Bashkinë Vlorë, Faza II, Rikonstruksioni i Unazës Vlorë Lot 2, si dhe ndërhyrjet në bulevard dhe Lungomare;
- Rigjenerimin urban të zonave bregdetare në fshatrat Jalë dhe Dhërmi;
- Rikualifikimin urban në fshatin Dhërmi;
- Rikualifikimin urban në fshatin Vuno;
- Rikualifikimi urban në Bashkinë Himarë, faza e parë;
- Ndërtimin e qendrës së turizmit Valbonë;

Eshtë lidhur kontrata për:

- Rikualifikimin urban të Tamarës (faza II) dhe rikonstruksionin e rrugës së Vermoshit;

Ndërkohë është në proces rishikimi projekti teknik:

- Rikualifikimi urban në Bashkinë Himarë, faza e dytë;

Në fazën e përgatitjes së dokumentacionit janë objektet:

- Rikualifikim urban dhe ndërtimi i qendrës turizmit në Vermosh;

Për të gjitha objektet që janë në fazë zbatimi kanë përfunduar procedurat e tenderimit dhe janë lidhur kontratat për supervizionin e punimeve. FSHZH është e angazhuar maksimalisht që punimet të përfundojnë brenda afateve të kontratave respektive. Sezoni turistik 2018 i gjeti këto zona me infrastrukturë të transformuar.

Përsa i përket komponentit të asistencës teknike dhe ngritjes së kapaciteteve, po punohet për realizimin e disa studimeve dhe organizimin e trajnimeve për Njësitë e Qeverisjes Vendore, në territorin e zbatimit të projektit.

Aneks 5. Informacion mbi nënprojektet e programit “Punët në Komunitet IV”, financuar nga CEB, Qeveria Shqiptare dhe NJQV-të përfituese (Dhjetor 2018);

2.1 Masterplani i Alpeve

Hartimin e Masterplanit është pjesë integrale e Programit “Punët në Komunitet IV”, Puna për hartimin e tij nisi gjatë vitit 2016 dhe përfundoi në Dhjetor 2017.

Studimi është financuar nga Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës në kuadër të asistencës teknike të “Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor” (WBIF).

Qëllimi kryesor i studimit është ofrimi i një plani zhvillimi social-ekonomik të qëndrueshëm për komunitetin e Alpeve Shqiptare si një nga zonat gjeografike me potencial të lartë të zhvillimit turistik.

Ai orienton zhvillimin e qëndrueshëm të zonës dhe i hap rrugë fillimit të investimeve të integruara me qëllim rritjen ekonomike të të gjithë rajonit përgjatë 15 viteve në vazhdim. Drejtimit kryesor të zhvillimit të zonës së alpeve sipas Planit Kombëtar Sektorial të Turizmit do të jenë: turizmi, zhvillimi rural, energjia, industria e lehtë, kulinaria, etj.

Në terma konkretë studimi orientohet drejt këtyre produkteve:

- Vlerësim i Situatës Aktuale dhe Kërkesa Turistike;
- Plan Kombëtar Sektorial i Turizmit;
- Propozim për Plan Marketingu;
- Program investimesh (studime fizibiliteti, projekte teknike) për projekte infrastrukturore lokale për kreditë e ardhshme CEB.

Plani Kombëtar Sektorial i Turizmit për Alpet shqiptare u miratua nga Këshilli Kombëtar i Territorit, më 9 dhjetor 2017.

Ky plan bashkë me studimin për kërkesën turistike, programin e investimeve për infrastrukturën vendore dhe strategjinë e marketingut turistik përbëjnë Masterplanin e Alpeve.

Zbatimi i këtij plani përgjatë 15 viteve, kombinuar me programin e investimeve për infrastrukturën vendore dhe strategjinë e marketingut turistik të zonës pritet të sjellë një përfitim ekonomik prej 980 milionë eurosh.

Numri i turistëve pritet të kapë shifrën rreth 600,000 brenda vitit 2031, ndërsa koha e qëndrimit pritet të zgjatet. Qasja rajonale e ndërhyrjeve në të gjithë zonën dhe në të gjithë zinxhirët e vlerës, si dhe ndërhyrjet minimaliste në peisazhet natyrore janë dy elementë të veçantë mbi të cilët është ngritur ky projekt.

3. Rikonstruksioni i rrugës së Lumit të Vlorës

Projekti parashikon ti japë zgjidhje të qëndrueshme infrastrukturës publike në zonën e Bregdetit të Jugut, specifikisht në zonën e Lumit të Vlorës, duke kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës për vendasit dhe ridimensionim e sektorit të turizmit si një nga shtyllat kryesore të ekonomisë lokale dhe rajonale.

Infrastruktura publike aktualisht nuk favorizon zhvillimin e ekonomisë dhe nuk ofron shërbime optimale për popullsinë vendase dhe turistët që frekuentojnë këtë zonë. Projekti ka si qëllim rikonstruksionin e rrugës së Lumit të Vlorës, e cila do të mundësojë lidhjen e dy rrugëve nacionale (SH4-SH8) dhe përfshin edhe një degëzim që mundëson lidhjen me qytetin e Vlorës.

Rruga e Lumit të Vlorës parashikohet të financohet në shumën rreth 86.6 milionë USD me TVSH, për gjatësinë e plotë të saj 90.4 km.

Financues të projektit janë Fondin Kuvajtian me 40 milionë USD dhe Fondi Saudit për rreth 30 milionë USD, Qeveria Shqiptare bashkëfinancon me rreth 16.6 milionë USD, të cilat do të përdoren për zbatimin e projektit dhe TVSH. Projekti ka filluar në vitin 2017 dhe parashikohet të përfundojë në vitin 2022.

Gjatë vitit 2016, u evidentuan të gjitha hapat që duhet të ndërmerreshin për hartimin e grafikut të realizimit të projektit dhe përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm. Fillimisht u punua me përgatitjen e termave të referencës për Supervizionin e Punimeve, të cilat morën formën përfundimtare pas pasqyrit të vërejtjeve dhe sugjerimeve të Fondit Kuvajtian dhe FSHZH.

Punimet civile kanë filluar për Lot I, By Pass Vlorë - Peshkëpi - Gjorm, me gjatësi 23.2 km. Kontrata është lidhur më 24.02.2017. Punimet në Lot I kanë vijuar normalisht përfshirë punime germimi dhe mbushje, ndërtim i mureve mbajtës dhe pritës, veshje skarpatah, ndërtimi i dy urave te reja gjatësi nga 18,4 dhe 2 x 16 m, vepra arti si dhe asfaltimi i rreth 19 km. Deri në Dhjetor 2018, ecuria e punimeve civile është në masën 80 përqind.

Është shpallur fituesi për kontratat e punimeve civile Lot II & Lot III. Parashikohet që kontrata e punimeve për Lotet II & III, të lidhet në Shkurt 2019. Është përzgjedhur mbikëqyrësi i punimeve për financimin e Fondit Kuvajtian. Supervizori është prezent në terren për mbikëqyrjen e punimeve të kryera dhe rishikimin e projekteve teknike për Lot-in e dytë dhe Lot-in e tretë.

Fondi Saudit për Zhvillim do të financojë me rreth 30 milionë USD pjesën e dytë të rrugës së Lumit të Vlorës, e cila lidh fshatin Peshkëpi me Selenicën dhe bashkohet me kryqëzimin e autostradës Levan - Tepelenë, duke plotësuar kështu të gjithë financimin e nevojshëm për ndërtimin e rrugës.

Pas firmosjes së marrëveshjes së këtij investimi ne Maj 2017, është lidhur kontrata me supervizionin për Lot IV. Kontrata e supervizionit të punimeve parashikon rishikimin e projektit dhe preventivin, duke bërë përmirësimet e nevojshme në përshtatje me kushtet në terren. Aktualisht supervizori është duke punuar me rishikimin e projektit, i cili do t'i hapë rrugë nisjes së procedurave për tenderimin e punimeve civile. Rishikimi i projektit parashikohet të zgjasë rreth 3 muaj.

Është aprovuar nga Fondi Kuvajtian për Zhvillim Arab një grant për Asistencë teknike, me vlerë rreth 700 mijë dollarë. Granti do të përdoret për të përgatitur

studime fizibiliteti për projekte infrastrukturore për zhvillimin e bregdetit të jugut. Në përfundim të këtij studimi do të gjenerohen projekte në shumën rreth 30 milionë dollarë, të cilat mund të paraqiten në donatorë të mundshëm për t'u financuar. Ky grant është bërë efektiv me 12.12.2017 dhe ka një afat përdorimi deri më 31.12.2020. Janë pregatitur termate e references dhe pritjet miratimi nga donatori për të vijuar me prokurimin.

Aneks 6. Informacion mbi projektin e Rrugës së Lumit të Vlorës Faza I, financuar nga Fondi Kuvajtian (Dhjetor 2018);

4. Projekti për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin (PZHIUT)

Prej fillimit të vitit 2016, FSHZH në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Urban, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, ka zhvilluar një aktivitet intensiv konsultimi, organizimi dhe planifikimi për përgatitjen e Projektit për Zhvillim të Integruar Urban dhe Turistik, i cili financohet nga Banka Botërore në vlerën 63.8 milionë Euro (me TVSH).

Projekti u bë zyrtarisht efektiv në fund të prillit 2017 dhe ka një kohëzgjatje 5 vjeçare deri në Korrik 2022. Ai shtrihet në qendrat urbane të Sarandës, Gjirokastrës, Beratit, Përmetit dhe përgjatë korridorit turistik që kalon në këtë rajon. Nga ky projekt parashikohet të përfitojnë 84 mijë banorë dhe rreth 300 mijë turistë.

Objektivi i projektit është përmirësimi i infrastrukturës urbane, nxitja e turizmit dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për të mbështetur turizmin dhe zhvillimin e ekonomisë lokale në zonat e përzgjedhura në jug të Shqipërisë.

Puna për zbatimin e projektit është e organizuar sipas tre komponentëve kryesorë.

Komponenti 1. Projektimi urban dhe përmirësimi i infrastrukturës (44.3 milionë Euro) i cili financon hartimin e projekteve për zbatimin e projektimit urban dhe investime për përmirësim të infrastrukturës bashkiake në katër qendrat urbane: Saranda, Gjirokastra, Berati dhe Përmeti.

Investimet në këto bashki të përzgjedhura përfshijnë rehabilitimin e hapësirave publike (psh, parqe, sheshe, pedonale), rrjet rrugor, nyje inter-modale dhe infrastrukturë shoqëruese (p.sh, trotualet, kryqëzimet rrugore, ndriçimet rrugore, korsitë e biçikletave, stacionet e autobusëve); restaurimin e ndërtesave të përzgjedhura të trashëgimisë dhe përmirësimin e fasadave të ndërtesave të zgjedhura dhe përmirësimin e zonave turistike (p.sh. rrugët hyrëse, qendrat e vizitorëve, vendparkimet, sinjalistikë turistike).

Ky komponent do të financojë gjithashtu përgatitjen e projekteve urbane, studimeve të fizibilitetit, projekteve inxhinierike dhe supervizimin e projekteve ndërtimore. Infrastruktura nëntokësore do të përfshihet si pjesë e përmirësimit të rrjetit rrugor, kur të jetë e nevojshme.

Komponenti 2. Përmirësimi i siteve turistike (8.4 milionë Euro), financon investime që kanë për qëllim përmirësimin e siteve turistike të përzgjedhura përgjatë korridorit turistik në Shqipërinë e Jugut.

Investimet përfshijnë restaurimin e objekteve të trashëgimisë dhe aseteve kulturore, përmirësimin e infrastrukturës mbështetëse. Ky komponent do të financojë gjithashtu përgatitjen e studimeve të fizibilitetit, planet e menaxhimit të siteve, projektet inxhinierike dhe supervizimin e projekteve ndërtimore.

Komponenti 3. Tregu i turizmit dhe zhvillimi i produkteve (7.7 milionë Euro), financon aktivitetet për përmirësimin e menaxhimit bashkiak dhe ofrimin e shërbimeve, si dhe zhvillimin e zinxhirit të vlerës. Ky komponent është i ndarë në dy komponentë plotësues:

- a) Mbështetja në ofrimin e shërbimeve bashkiake. Ky nënkomponent financon:
- (i) aktivitetet që synojnë përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe menaxhimin bashkiak në bashkitë në zonën e projektit. Aktivitetet do të përfshijnë asistencë teknike dhe mjete për menaxhimin e përmirësuar bashkiak (për shëmbull, sistemet e menaxhimit të aseteve dhe GIS).
 - (ii) asistencën teknike që synon përmirësimin e ofrimit të shërbimeve (për shëmbull: studimet e menaxhimit të trafikut) dhe rritjen e funksionimit të aseteve të rehabilituara në kuadër të projektit dhe pajisjeve të zgjedhura (p.sh. grumbullimin e mbetjeve të ngurta).
- b) Zhvillimi i produkteve turistike dhe zinxhirit të vlerës. Ky nënkomponent financon:
- (i) kërkimin e tregut për të udhëhequr aktivitetet e zhvillimit të produktit;
 - (ii) aktivitetet që mbështesin krijimin e partneriteteve për menaxhimin e destinacionit në nivel bashkiak dhe rajonal;
 - (iii) zhvillimin e së paku 20 produkteve të reja turistike në zonën e projektit dhe,
 - (iv) krijimin e një sistemi të statistikave kombëtare të turizmit;

Gjatë kësaj periudhe FSHZH ka punuar intensivisht me ekipin e Bankës Botërore Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe MZHU me qëllim realizimin e objektivave të zbatimit të projektit.

Përsa i përket komponentit të parë vlen të theksohet se kanë përfunduar punimet për:

- Ndriçimin e rrugës hyrëse në Përmet;
- Rehabilitimin e rrugës këmbësore për në Kalanë e Beratit dhe pikës panoramike jugore të Kalasë së Beratit "Tabja";

Ndërkohë vijojnë punimet në terren për:

- Rehabilitimin e shkallareve në qendrën e qytetit të Sarandës;
- Rehabilitimin e infrastrukturës dhe restaurimin e kalldrëmeve, në pazarin e Gjirokastrës;

FSHZH po vijon punën për përgatitjen e projekteve teknike dhe dokumentacionit të tenderimit për një numër projektesh të tjera si:

- "Rehabilitimi i shtegut të Ali Pashës dhe stabilizimi i skarpateve pranë Kalasë Gjirokastrë";
- Ndriçimi i qendrës historike të qytetit të Gjirokastrës;
- Përmirësimi i integruar urban i infrastrukturës në qytetin e Gjirokastrës;
- Restaurimi dhe përmirësimi i sistemit të muzeve në Gjirokastrë;
- Rigjenerimi urban i shëtitores ekzistuese "Naim Frashëri" në Sarandë;
- Përmirësimi i integruar urban i infrastrukturës për qytetin e Sarandës;
- Përmirësimi i integruar urban i infrastrukturës për qytetet e Beratit dhe Përmetit;
- Hartimi i projekteve të zbatimit dhe supervizioni i ndërtimit të infrastrukturës së pikave panoramike përgjate korridorit turistik në jug të Shqipërisë;

- Planet e Menaxhimit të sitit, interpretimin dhe eksperiencën turistike për sitet turistike Zvërnec - Nartë & Ujrat Termal të Bënjës;
- Planet e Menaxhimit të sitit, interpretimin dhe eksperiencën turistike për sitet turistike te Porto Palermos.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë dorëzuar pajisjet teknologjike pranë Stacionit të Transferimit të Mbetjeve në Himarë.

Në kuadër të investimeve për rehabilitimin e këtyre nënprojekteve janë zhvilluar konsultime me publikun dhe institucione të ndryshme në nivel qendror dhe lokal.

Studime dhe konsulenca të zhvilluara në kuadër të zbatimit të projektit:

- Konsulenca mbi “Krijimin dhe zhvillimin e sistemit të muzeve në qytetin e Gjirokastrës”, ka si qëllim projektimin dhe supervizimin e një sistemi miqësor (që do të thotë i lehtë për akses, interpretim tërheqës i lidhur me historinë e Gjirokastrës dhe rajonit) për turistët, ku ndërlidhen muze dhe atraksione të ndryshme të Gjirokastrës. Në fund të Dhjetorit ka përfunduar procesi i kontraktimit të konsulences. Puna për hartimin e projektit parashikohet të zgjasë 9 muaj.
- Konsulenca mbi “Përmirësimin e integruar urban të infrastrukturës për qytetet e Beratit dhe Përmetit”, ka për qëllim përmirësimin urban të qyteteve duke rigjeneruar dhe rivitalizuar zonat kyçe brenda qendrave urbane. Studimi synon gjithashtu të ruajë dhe të shfrytëzojë trashëgiminë kulturore dhe të përmirësojë aksesin në zonat historike. Kontrata u nënshkrua më 31 Maj 2018 dhe u bë efektive në 4 Qershor 2018. Konsulenca vijon punën për hartimin e projektit. Aktualisht kanë përfunduar me sukses 2 produktet e para dhe ndërkohë është duke punuar për produktin e tretë. Kohëzgjatja e kontratës 13.5 muaj.
- Konsulenca “Përmirësimi i integruar urban i infrastrukturës urbane për qytetin e Gjirokastrës”, ka për qëllim gjetjen e mundësive për ta kthyer zonën e pazarit në funksion të këmbësoreve duke e bërë atë më tërheqëse dhe të arritshme për turistët, krijimin e hapësirave të parkimit jashtë zonës së mbrojtur, ndërlidhjen efikase mes transportit publik, transportit të motorizuar dhe transportit të pa-motorizuar. Studimi synon gjithashtu përmirësimin e lidhjes brenda qendrës historike, përmirësimin urban të qytetit, me fokus ringjalljen e infrastrukturës në zonat historike, rigjallërimin e hapësirave publike, përmirësimin e rrugëve, rinovimin e fasadave dhe restaurimin e ndërtesave të trashëgimisë të përzgjedhura për ripërdorim adaptiv. Kontrata është nënshkruar më 20 Shtator 2018 dhe është bërë efektive në 4 tetor 2018. Konsulenti ka dorëzuar produktin parë Aktualisht, ka nisur puna për produktin e dytë: Lëvizja dhe Urbanizimi, plani historik i mobilitetit të qytetit. Në këtë kuadër është dorëzuar Vlerësimi i Terrenit Urban dhe Vlerësimi i Lëvizshmërisë i cili po komentohet nga aktorët.
- “Përmirësimi i integruar urban i infrastrukturës për qytetin e Sarandës”, ka për qëllim përmirësimin e mobilitetit në zonën qendrore të qytetit, përmirësimin e rrugëve duke promovuar kalimin nga transporti privat drejt transportit publik, krijimin e hapësirave për ecje dhe biçikleta në zona të ndryshme të qytetit, lidhjen me zonat përreth (psh Ksamili në jug). Studimi synon njëkohësisht përmirësimin dhe ruajtjen e hapësirave publike dhe integrimin e zonave të gjelbërta dhe rekreative brenda zonës së studimit. Kontrata është firmosur në datën 16 nëntor 2018 dhe u bë efektive në datën 1 dhjetor 2018. Konsulenti ka nisur punën për hartimin e produktit të parë: Raporti fillestar dhe Plani i Punës, i cili do të dorëzohet në fillim të vitit 2019. Kontrata e projektimit parashikohet të përfundojë në qershor 2020.

- “Rehabilitimi i shtegut të Ali Pashës, Gjirokastër dhe stabilizimi i skarpateve pranë Kalasë Gjirokastër”, ka si objektiv zhvillimin e projektit të infrastrukturës dhe restaurimit të sistemit të rrugëve/shtigjeve të Ali Pashës dhe prioritetet inxhinierike, masave teknike, ndërhyrjeve për ruajtjen e mureve të kalasë dhe stabilizimin e shpateve. Janë përgatitur draft Termat e Referencës së konsulencës dhe pritet miratimi i tyre nga aktorët. Procesi i prokurimit për shërbimet e projektimit të kësaj kontrate pritet të fillojë në Mars 2019.
- “Rigjeneri urban i shëtitorës ekzistuese “Naim Frashëri” në Sarandë”, ka si objektiv kryesor rinovimin e shëtitorës ekzistuese “Naim Frashëri” dhe përmirësimin e fasadave të objekteve përgjatë shëtitorës. Shëtitorja ka një gjatësi prej 1.2 km dhe një sipërfaqe prej 28,420 m². Kontrata midis FSHZH dhe JV “Symbiotica” sh.p.k. dhe “Dea Studio” sh.p.k. është firmosur në datën 10 shtator 2017. Për shkak të problematikave të ndryshme gjatë procesit të hartimit të projektit afati i kësaj kontrate është shtyrë deri në fillim të vitit 2019. Pas përzgjedhjes së një prej 3 varjenteve të prezantuara nga konsulenti ka vijuar puna për përgatitjen e fazës finale të projektit të zbatimit i cili është drejt përfundimit. Punimet për këtë projekt parashikohen të nisnin gjatë vitit 2019.

“Planet e Menaxhimit të sitit, interpretimi dhe eksperiencia turistike për sitet turistike Nartë - Zvërnec & Ujrat Termale të Bënjës”. Qëllimi i kësaj konsulence është identifikimi dhe përmirësimi i elementëve kryesorë të eksperiencës turistike në sitet Nartë - Zvërnec dhe Ujërat Termale të Bënjës, të tilla si interpretimi i siteve, aksesit, siguria e vizitorëve, përgatitja e planeve të menaxhimit dhe të mirëmbajtjes për të dy sitet, si dhe dizajni dhe supervizimi i punimeve të identifikuar.

Kontrata me Joint Venture “Abkons” sh.p.k. dhe “Metropolis” sh.p.k. u firmos kontrata me datë 24 tetor 2018. Me aktivizimin e kontratës, dy javë nga firmosja e saj, konsulenti ka filluar punën për përgatitjen e Inception Report sipas kërkesave të termave të referencës.

Si pjesë e paketës së dytë të siteve turistike, është duke u punuar për përgatitjen e termave të referencës për konsulencën “Plani i Menaxhimit të sitit, interpretimit dhe eksperiencës turistike për Porto Palermon”.

Me qëllim grupimin e siteve turistike ku do të ndërhyhet, janë zhvilluar dhe vizita për vlerësimin në terren të mundësive të aksesit për në Parkun Arkeologjik të Orikut, për të cilin aksesit nga vizitorët/turistët nuk është i garantuar gjatë gjithë vitit. Aktualisht rezultojnë të jenë 3 opsione për akses, por më i mundshmi dhe më pak i kushtueshmi ekonomikisht mbetet shtyrja e portës së Forcave të Armatosura pas vendndodhjes së parkut. Për këtë arsye FSHZH ka punuar për arritjen e një marrëveshjeje të përhershme ndërmjet Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe Ministrisë së Mbrojtjes për shtyrjen e pikës së kontrollit duke garantuar një akses të përhershëm të vizitorëve/turistive në këtë sit turistik. Mosarritja e kësaj marrëveshjeje ka çuar në një vendimmarrje të përbashkët ndërmjet WB dhe FSHZH për të mos përfshirë parkun arkeologjik të Orikut në listën e siteve turistike ku do të investojë projekti.

Në datën 30.03.2018 është lidhur kontrata midis “Anaplasi Consultancy Engineers” SA dhe FSHZH për konsulencën e “Hartimit të projekteve të zbatimit dhe supervizionin e ndërtimit të infrastrukturës së pikave panoramike përgjatë korridorit turistik në jug të Shqipërisë”. Konsulenti ka përgatitur fazën e dytë të projektit e cila ka të bëjë me identifikimin e pikave panoramike/vendqëndrimet duke marrë në konsideratë propozimet e Bashkive (pjesë e këtij korridori), por edhe shumë palëve të tjera të interesuara si agjenci apo operatorë të ndryshëm turistikë. Pas rishikimit të produktit të dytë nga ekipet e BB, FSHZH dhe PCU konsulentit i janë dërguar komentet të cilat janë të nevojshme për t’u reflektuar në mënyrë që të bëhet dhe përcaktimi i listës përfundimtare të pikave ku do të investohet. Konsulenti ka hasur

vështirësi në reflektimin e komenteve duke mos plotësuar kërkesat e Termave të Referencës. FSHZH dhe PCU do të mbeshtesin konsulentin për plotësimin e këtij produkti për të vijuar më pas me produktet e tjera të kësaj kontrate.

Në komponentin e tretë, ka përfunduar studimi për “Përgatitjen e kërkimit të tregut dhe zhvillimin e strategjisë së produktit dhe tregut turistik për Jugun e Shqipërisë si dhe 4 bashkitë e përzgjedhura” Produktet e përgatitura nga kjo konsulencë, “Kërkimi i tregut dhe analiza e zinxhirit të vlerës” si dhe “Strategjia 2 vjeçare e marketingut dhe zhvillimit të produktit si dhe plani i veprimit të menaxhimit të destinacionit” kanë hedhur bazat për konsulencat e ardhshme të cilat do të kenë si fokus zbatimin e strategjisë marketing, zhvillimin e produkteve turistike në 4 bashkitë përfituese të projektit si dhe ngritjen e organizatave të menaxhimit të destinacionit të parashikuara në PZHIUT.

Aneks 7. Informacion mbi Projektin për Zhvillimin e Integruar dhe Turizmin, financuar nga Banka Botërore (Dhjetor 2018)

5. Programi i Rrugëve Lidhëse Rajonale.

Programi parashikon ndërhyrje në rrjetin rrugor rajonal në zona me potencial bujqësor dhe turistik në të gjithë vendin. Ai do të financohet nga Banka Botërore dhe BERZH me vlerë financimi 100 milionë USD.

Në fazën e parë, u finalizua një listë financimi për vitin e parë të programit, për rreth 60 km rrugë që kanë një ndikim të rëndësishëm në turizëm, për të cilat me dakordësinë e Bankës Botërore dhe fondet e buxhetit të shtetit u krye me sukses procesi i prokurimit dhe kontraktimit të projektimit. Nga ana e projektuesve janë dorëzuar variantet finale të projekt zbatimit për segmentet rrugore Qafë Thore - Theth dhe Pogradec - Tushemisht.

Projekti Pogradec - Tushemisht është tenderuar dhe pritet të fillojë punimet në Mars 2019. Projekt zbatimi i segmentit Qafë Thore - Theth pritet të tenderohet në Mars 2019. Ndërkohë vijon puna për përgatitjen e variantit final të projekt zbatimit për rrugën Fier - Seman.

Më poshtë jepen disa detaje mbi 3 segmentet e para të cilat parashikohet të financohen:

- Fier - Seman, 18.2 km, një segment kryesor turistik i bashkisë Fier që lidh me bregdetin por edhe një numër të rëndësishëm komunitetesh gjatë saj.
- Qafë Thore - Theth 16 km. Segmenti përfundon lidhjen e fshatit dhe parkut kombëtar të Thethit, një rrugë shumë e dëmtuar dhe e rrezikshme në një zonë gjithnjë e më të frekuentuar në veçanti nga turistët e huaj.
- Pogradec - Tushemisht 6.25 km. Është rruga kryesore që lidh Pogradecin me Tushemishtin dhe me pikën kufitare të Maqedonisë. Investimi në këtë rrugë që është në linjën e brendshme të liqenit krijon mundësinë e rikonceptimit si hapësirë e madhe publike e vijës së bregut të liqenit nga Pogradeci në Drilon.

Faza e dytë do të vazhdojë me analizën e projekteve të sjella nga bashkitë dhe përgatitjen e një liste investimesh për pjesën e mbetur të 3-4 viteve të kohëzgjatjes së programit. Potencialisht kjo listë do t'u shërbejë edhe donatorëve të tjerë apo qeverisë për identifikimin dhe financimin e rrugëve më të rëndësishme dytësore në vend. Parashikohet që zbatimi i punimeve civile në terren për 3 segmentet e para rrugore të fillojë gjatë vitit 2019.

6. Programi i Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale

Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale (FUZR) është një program i bashkëfinancuar nga Qeveria Shqiptare, Banka Gjermane për Zhvillim - KfW (Bashkëpunimi Gjerman - Asistenca Financiare), dhe Bashkimi European. I ndarë në disa projekte të veçanta ky program përbën një nga iniciativat më serioze të 10 viteve të fundit për të përmirësuar furnizimin me ujë të pijshëm të zonave rurale. Ky program ka arritur deri më sot një financim total prej 57.43 milionë Euro. Përmes këtyre financimeve përfitojnë më shumë se 135,000 banorë në zonat rurale, duke mundur kështu furnizim me ujë të pijshëm dhe higjienikisht të pastër.

Aktualisht është duke u zbatuar projekti “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III”, i cili synon të mbulojë me shërbim të furnizimit me ujë më shumë se 75,000 banorë.

Projekti “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale IV”, gjatë vitit 2018, ka nisur fazën përgatitore të tij me studimin e fizibilitetit i cili ka përfunduar dhe është miratuar nga KfW.

Projekti parashikon ndërhyrje të plota në të gjithë sistemin e furnizimit me ujë dhe atë të ujërave të zeza, ndërtimin e një impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Bashkinë Himarë dhe vendosjen në funksionim të impiantit të trajtimit në qytetin e Orikumit. Ai do të financohet nga KfW, WBIF, Qeveria Shqiptare, me vlerë të pritshme financimi 53 milionë Euro. Projekti parashikohet të bëhet efektiv gjatë vitit 2019 dhe do të ketë kohëzgjatje 5 vjeçare.

Programi	Kohë zgjatja	Financimi Euro (milion)	Qarqet ku implementohet	Popullsia që shërbehet me ujë (banorë)	Nr. i fshatrave
FUZR I & II	2008-2016	11.66	Kukës, Dibër, Shkodër	40,000	53
SIF IV	2010-2017	5.8	Kukës, Dibër, Shkodër	20,000	26
FUZR III	2015-2019	39.97	Të gjitha Qarqet e Shqipërisë	75,000	88
FUZR IV ⁶	2019-2023	53	Vlorë (Bashkia Himarë)	8,000 banorë dhe mbi 50 mijë turistë	10

6.1 “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III”

Projekti “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III”, parashikon ndërhyrje në shkallë të gjërë në të gjithë vendin. Financues të këtij programi janë KfW me 25.5 milionë Euro dhe Bashkimi European përmes IPA 2013, me 9.8 milionë Euro si dhe Qeveria Shqiptare me 4 milionë Euro.

Në këtë kuadër me financim nga WBIF në shumën 670,000 Euro, gjatë periudhës Nëntor 2015 - Maj 2016, u hartuan fizibilitetet teknike dhe sociale.

Në fund të këtij procesi u administruan 252 aplikime nga 59 bashki. Bashkitë Elbasan dhe Konispol nuk kanë aplikuar në proces. Përgatitja e fizibiliteteve teknike, sociale dhe mjedisore ka përfunduar për 30 skema, nga të cilat 19 prej tyre kanë rezultuar fizibel. KfW ka dhënë miratimin për 18 skemat e para dhe pritet miratimi i skemave të tjera shtesë, për të cilat janë duke u përgatitur fizibilitetet teknike. 18 nga skemat e

⁶ Vlera e pritshme e financimit të FUZR IV është rreth 53 milionë Euro

miratuara kanë përfunduar fazën e projektimit gjatë vitit 2018, dhe pjesërisht janë tenderuar ose janë në proces tenderimi.

Në Qershor 2017 është lidhur kontrata me kompaninë fituese për përgatitjen e projekteve si dhe supervizionin e punimeve civile dhe ka filluar zbatimin e saj.

Periudha e parashikuar për hartimin e projekteve është 14 muaj. Në muajt e parë të kontratës, janë përgatitur projektet e para për zbatim për Lotin I dhe në vijim gjatë vitit 2018 deri në Tetor kanë përfunduar projektet teknike edhe për 3 lotet e tjera.

Puna në terren për ndërtimin e ujësjellësave do të organizohet në Lot-e dhe parashikohet të fillojë me përfundimin e projektit teknik të Lotit I. Disbursimet kanë filluar pas firmosjes së kontratës së Projektimit me konsulencën.

Gjatë vitit 2018, janë përgatitur 18 projekte teknike të LOT I,II, III dhe IV. Projektet janë kontrolluar dhe komentuar nga FSHZH dhe kanë marrë miratimin e KfW-së.

Për Lot I, tenderi i punimeve civile është shpallur në 12 Maj 2018. Në 16 Korrik është bërë hapja e ofertave teknike dhe në datë 29 Korrik është dërguar raporti i vlerësimit KfW-së, e cila dha miratimin në 21 Shtator 2018. Për këtë Lot, vijojnë negociatat me kompaninë fituese.

Për Lot II, tenderi i punimeve civile është shpallur 10 Gusht 2018. Në 24 Shtator është bërë hapja e ofertave teknike dhe në fund të vitit 2018 ka përfunduar procesi i vlerësimit. Është rënë dakord me KfW që të aplikohet procedura "post kualifikuese". Kontrata e zbatimit parashikohet të lidhet në fillim të vitit 2019.

Për Lot III, projektet teknike kanë përfunduar për të gjitha projektet në 15 Tetor 2018. Shpallja e tenderit parashikohet të bëhet gjatë tremujorit të parë 2019.

Për Lotin IV, projektet teknike kanë përfunduar të gjitha dhe janë miratuar nga KfW për të vijuar më pas me shpalljen e tenderit. Tenderi i punimeve për këtë Lot u shpall në 22 nëntor dhe dorëzimi i ofertave është në 7 janar 2019, për të vijuar më tej me procesin e vlerësimit.

Puna në terren për ndërtimin e ujësjellësave do të organizohet në Lot-e. Disbursimet kanë filluar pas firmosjes së kontratës së Projektimit me konsulencën.

***Aneks 8.** Informacion mbi skemat e ujësjellësave të përzgjedhur për përgatitjen e projekteve teknike në kuadër të programit "FUZR III", financuar nga KfW, IPA 2013 dhe Qeveria Shqiptare (Dhjetor 2018);*

6.2 "Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale IV",

FUZR IV parashikon ndërhyrje të integruar në Bashkinë Himarë dhe vlerë financimi rreth 53 milionë Euro. Ky projekt përfshin zonën e qytetit të Himarës, fshatrat Kuç, Buronjë (afër Kuç), Pilur, Kudhës, Vuno, Jal, Livadhi, Himara Fshat, Qeparo. Njëkohësisht projekti parashikon një studim për gjendjen e sistemit të kanalizimeve në NjA Orikum dhe riparime për vendosjen në funksionim të impiantit ekzistues në Orikum. Varësisht nga gjetjet e studimit do të elaborohen edhe mundësitë e ndërhyrjes me investime. Nga ky projekt parashikohet të përfitojnë rreth 50,000 përfitues të drejtpërdrejtë dhe turistë që frekuentojnë zonën.

Objektivi i këtij projekti është të përmirësojë dhe sigurojë akses të qëndrueshëm në furnizimin me ujë të pijshëm për popullsinë rezidente dhe turistët, me kosto dhe tarifa sociale të pranueshme. Ai do të sigurojë krijimin e kushteve higjieno sanitare të

përshtatshme përmes sistemit të kanalizimeve, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe përmirësimin e kapaciteteve menaxhuese.

Projekti do të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe do të promovojë zhvillimin e turizmit në rajon.

Në Maj 2018 është nënshkruar Marrëveshja e financimit të grantit 750 mijë euro i siguruar nga Qeveria Federale Gjermane nëpërmjet KfW. Financimi parashikon studimin e fizibilitetit për financimin e shërbimeve të konsulencës.

Puna për studimin e fizibilitetit të projektit nisi në Shkurt 2018 dhe përfundoi në Nëntor të po këtij viti. Studimi është dorëzuar dhe miratuar nga KfW.

KfW për të kompletuar këtë studim, ka akorduar nga fondet e veta speciale edhe Investigimin e Burimit të Lëpushës për verifikimin e prurjeve, si dhe ka kontraktuar një kompani konsulente për përgatitjen e Fizibilitetit Teknik për pjesën e Orikumit ku përfshihen kanalizimet, vlerësimi për vënien në funksionim të Impiantit dhe masa për pajisjen me matësa uji për qytetin e Orikumit. Studimi final i Fisibilitetit për Orikumin do të dorëzohet në Shkurt 2019. Referuar gjetjeve nga raportet dhe kostot respektive, është draftuar edhe marrëveshja e financimit.

Gjatë fundit të vitit 2018, ka patur korrespondenca me KfW në lidhje me draft marrëveshjet dhe negociatat mes Qeverise Shqiptare dhe KfW-së për marrëveshjen e kredisë për financimin e projektit teknik, punimeve civile, masave shoqëruese etj. Draft marrëveshjet janë përgatitur nga KfW dhe komentuar nga FSHZH si dhe nisur ministrive të linjës për komente të mëtejshme.

Prokurimi

Gjatë muajit Prill 2016, u bë shpallja për tenderin parakualifikues të Projektim Supervizionit për Programin RWSP III. Në 23 Maj 2016, u paraqitën edhe ofertat nga 14 kompani.

Në 2 Dhjetor 2016, u hapën propozimet teknike nga kompanitë e parakualifikuara, për tenderin e projektim supervizionit për fazën post-kualifikuese për programin RWSP III. Vlerësimi është bërë nga një agjent tenderues i përcaktuar nga KfW. KfW ka dhënë miratimin për vlerësimin e propozimit teknik në datë 01.02.2017. Në 22.02.2017, KfW ka dhënë miratimin për vlerësimin Financiar.

Në datë 7 Qershor 2018, është bërë shpallja e tenderit të konsulencës për “Masat Shoqëruese të FUZR III”, shuma 1,500,000 Euro. Tenderi është hapur në datë 9 Korrik 2018 për fazën parakualifikuese dhe miratimi nga KfW ka ardhur në 17 Shtator 2018. Faza e dyte e tenderit është njoftuar në datë 12 Nëntor 2018. Deri në fund të vitit 2018 ka vijuar vlerësimi për pjesën teknike dhe ofertën financiare. Raporti i vlerësimit i është nisur KfW për miratim.

Për Lot I, tenderi i punimeve civile është shpallur në 12 Maj 2018. Në 16 Korrik është bërë hapja e ofertave teknike dhe në datë 29 Korrik është dërguar raporti i vlerësimit KfW-së, e cila dha miratimin në 21 Shtator 2018. Hapja e ofertave financiare, do të kryhet në 15 tetor 2018. Janë hapur ofertat financiare dhe pas vlerësimit, tenderuesi potencial për të fituar, është tërhequr nga gara. FSHZH së bashku me KfW ka rënë dakord që të negociohet me ofertuesin e dytë në garë.

Për Lot II, tenderi i punimeve civile është shpallur 10 Gusht 2018. Në 24 Shtator është bërë hapja e ofertave teknike dhe po punohet me raportin e vlerësimit. Është rënë dakord me KfW që të aplikohet procedura “post kualifikuese”.

Për LOT IV është shpallur tenderi në datë 22 Nentor 2018. Në date 7 Janar 2019, do të paraqiten ofertat.

Procedurat mjedisore

Në kuadër të zbatimit të procedurave për mbrojtjen e mjedisit të programit “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale”, janë kryer këto aktivitete:

- Janë miratuar të gjitha lejet e nevojshme për vijimin e punës me Lot 1, përfshi dhe ato mjedisore.
- Janë miratuar lejet e mjedisore dhe janë në proces lejet e ndërtimit për Lot 2.
- Ndekja e procedurave për marrjen e lejeve mjedisore dhe të ndërtimit për Lot III dhe IV.
- Janë përfunduar VNM nga konsulenca CES dhe kanë nisur aplikimet për leje në bashkëpunim me bashkitë përfituese.

Konkluzione:

Menaxhimi profesional dhe zbatimi i suksesshëm i programeve FUZR I, II, dhe SIF IV, ka rezultuar me përfitimin e financimeve të tjera, të cilat po përdoren për zbatimin e projektit FUZR III.

Në këtë kuadër, u sigurua një financim nga WBIF në shumën 750,000 Euro, të cilat u përdorën për hartimin e fizibiliteteve teknike dhe sociale në kuadër të projektit Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III, i cili ka shtrirje në të gjithë vendin. Financues të këtij projekti janë KfW me 25.5 milionë Euro dhe Bashkimi Europian përmes IPA 2013, me 9.8 milionë Euro si dhe Qeveria Shqiptare me 4 milionë Euro.

FSHZH ka aplikuar për një tjetër projekt investimi i cili do të fokusohet në Bashkinë Himarë dhe do të mbulojë fshatrat Kuç, Buronjë, Pilur, Kudhës, Vuno, Jalë, Livadhi, Himarë Fshat dhe Qeparo.

Projekti FUZR IV, do të përfshijë investime në ujësjellës kanalizime, dhe ndërtimin e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura të Himarës. Ky projekt është paravlerësuar me një buxhet prej rreth 50 Milionë Euro kredi, që do të financohet nga KfW për ndërtimin dhe 2 milionë Euro grant për masa shoqëruese.

Aktualisht është përgatitur marrëveshja për financimin e përgatitjes së fizibilitetit teknik, i cili do të financohet nga granti 750,000 Euro i KfW. Në këtë projekt, është miratuar bashkëfinancimi nga WBIF për financimin e projektimit në vlerën 1,8 milionë Euro dhe gjatë vitit 2019 do të bëhet aplikimi për financimin e supervizionit në vlerën 2.2 milionë Euro. Kohëzgjatja e këtij programi do të jetë 5 vjeçare, nga viti 2019 deri në vitin 2023.

7. Programet e financuara nga IPA, Bashkimi Evropian

Fondi Shqiptar i Zhvillimit është përzgjedhur si partner në 6 projekte IPA (Instrumenti i ndihmës së para-aderimit). Katër nga projektet financohen nga programi Interreg Adrion, një nga programi Interreg MED dhe një nga Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Shqipëri-Kosovë. Zbatimi i këtyre projekteve ka për qëllim nxitjen e bashkëpunimit dhe solidaritetit midis shteteve partnere në këto programe, përfitimin nga zhvillimet e ndërsjellta në burimet e pasura natyrore, kulturore dhe njerëzore si dhe kontribut në rritjen e kohezionin ekonomik, social dhe territorial në rajon.

Programi Adrion investon në sistemet rajonale të inovacionit, trashëgiminë kulturore dhe natyrore, ndryshimet në mjedis, transportin e qëndrueshëm dhe lëvizshmërinë, të kombinuara me ngritjen e kapaciteteve.

Programi Interreg MED ka objektiv kryesor promovimin e rritjes së qëndrueshme në zonën e Mesdheut duke nxitur konceptet dhe praktikën e reja dhe përdorimin e arsyeshëm të burimeve. Programi mbështet integrimin social përmes një qasjeje të integruar dhe të bashkëpunimit të bazuar në territor. Investimet në kuadër të këtij programi fokusohen në fusha si mbrojtja e burimeve natyrore dhe kulturore dhe fuqizimi i inovacioneve.

Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Maqedoni-Shqipëri (2014-2020), mbështet bashkëpunimin ndërkufitar me qëllim promovimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, nxitjen e integritimit evropian, dhe të promovimit të zhvillimit socio-ekonomik.

Programi përqendrohet në 3 prioritetet tematike, që derivojnë nga analiza nevojë-mundësi dhe janë si më poshtë:

- Inkurajimi i turizmit dhe trashëgimisë kulturore;
- Rritja e konkurrueshmërisë, biznesit, tregtisë dhe investimeve;
- Mbrojtja e mjedisit, promovimi i përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike, rrishtu parandalimi dhe menaxhimi;

Programi i Bashkëpunimit ndërkufitar Greqi-Shqipëri (2014-2020) ka si objektiv të përgjithshëm "të rrisë standardin e jetesës së popullsisë duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm lokal, në zonën ndërkufitare". Programi përqendrohet në prioritetet që ose karakterizohen nga efekte të rëndësishme ndërkufitare ose paraqesin një potencial të lartë për arritjen e vlerës së shtuar nëpërmjet bashkëpunimit.

Ky program mbështetet në dy akse prioritare si më poshtë:

- Promovimi i mjedisit dhe infrastrukturë e qëndrueshme transporti dhe infrastrukturë publike;
- Nxitja e ekonomisë lokale;

Programi i Bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri - Kosovë (2014-2020), nxit bashkëpunimin midis Shqipërisë dhe Kosovës në zonat që kanë lidhje të drejtpërdrejta në kufi ose në afërsi të tyre. Programi synon të trajtojë sfidat e përbashkëta të identifikuar në rajonet kufitare dhe të shfrytëzojë potencialet ekonomike në zonat kufitare, duke rritur procesin e bashkëpunimit. Projekti në të cilin FSHZH është përzgjedhur inkurajon turizmin dhe promovon trashëgiminë natyrore dhe kulturore.

Programi i Bashkëpunimit ndërkufitar Itali - Shqipëri - Mal i Zi (2014-2020), është një program i bashkëfinancuar nga bashkimi evropian nëpërmjet instrumentit të para-aderimit dhe ka një buxhet total prej 92 Milion Euro. Ky program menaxhohet nga rajoni i Puljas dhe ka si objektiv të promovojë ngritjen ekonomike dhe të

intensifikojë bashkëpunimin në pjesën e poshtme të zonës së Adriatikut, duke zbatuar aksione të përbashkëta midis institucioneve kombëtare dhe rajonale dhe aktorëve jo-fitimprurës, duke mbështetur zhvillimin gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm. Ky program është i bazuar në 4 akse prioritare si më poshtë:

- Konkurrueshmëria e NMV;
- Turizmi dhe Kultura;
- Mjedi dhe Energjia;
- Transporti i Qëndrueshëm.

Projektet në total kanë një vlerë prej më shumë se 1.5 Milion Euro dhe kanë filluar zbatimin në fillim të vitit 2018.

Në zbatim të VKM Nr.438, datë 18.07.2018, funksionet institucionale të Agjencive për Zhvillim Rajonal, i kaluan Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Në këtë kuadër dhe në bazë të Udhëzimit me nr Prot. 1074, dt 30.07.2018, në lidhje me projektet me financim të huaj, u vijua zbatimi i aktiviteteve të projekteve si dhe përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga këto bashkëpunime.

Agjencitë e Zhvillimit Rajonal menaxhojnë në total 4 projekte: dy projekte të cilat financohen nga programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mal i Zi 2014 - 2020, një nga programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Interreg IPA CBC Greqi-Shqipëri 2014 - 2020 dhe një projekt në kuadër të programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Maqedoni - Shqipëri 2014 - 2020. Projektet në total kanë një vlerë prej 569,063 Euro dhe kanë filluar zbatimin në fillim të vitit 2018.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit është siguruar gjithashtu të adresojë ndryshimet e duhura të dokumentacionit kontraktual dhe bankar, duke plotësuar kërkesat e programeve specifike.

Gjatë tremujorit të parë të këtij viti, FSHZH në bashkëpunim me organizatat dhe agjencitë partnere është angazhuar në detajimin e objektivave të projekteve, analizën e gjendjes aktuale për secilën nga tematikat dhe fushat e ndërhyrjes dhe hartimin e metodologjisë së ndërhyrjeve.

Gjatë tremujorit të dytë puna ka vazhduar me hartimin e metodologjisë së implementimit, planifikimin e aktiviteteve, identifikimin e aktorëve të interesuar dhe planifikimin e përfshirjes së tyre në zbatimin e projektit.

Gjatë tremujorit të tretë dhe të katërt puna është fokusuar kryesisht në menaxhimin e projekteve, raportimin financiar dhe hartimin e termave të referencës për përzgjedhjen e eksperteve të kërkuar nga projektet përkatëse. Gjithashtu organizimi i takimeve sipas planit të punës për secilin projekt për realizimin e objektivave dhe indikatorëve ishte fokusi kryesor.

Projekti “Impreco”:

Strategjitë e përbashkëta dhe praktikat më të mira për të përmirësuar mbrojtjen rajonale të ekosistemit dhe shërbimeve ndaj tij

Buxheti i projektit	1,142,165 Euro
Buxheti i projektit për Shqipërinë	112,015 Euro
Kohëzgjatja:	24 muaj (Mars 2018 - Shkurt 2020)
Financues:	Bashkimi Europian, Programi ADRIION
Shtetet pjesëmarrëse:	Itali, Slloveni, Kroaci, Greqi, Shqipëri
Objektivi i projektit:	Rritja e mbrojtjes së shërbimeve të ekosistemit dhe trajtimi i cënueshmërisë së tyre mjedisore.

Projekti adreson këto sfida që mbështesin zonat e mbrojtura të 7 rajoneve të ADRION-it përmes rjetëzimit të tyre ndërshtetëror dhe zhvillimit të sistemeve të menaxhimit me bazë komunitare.

Projekti fokusohet në drejtim të rritjes së njohurive dhe shërbimeve të ekosistemit, përmirësimit dhe menaxhimit të shërbimeve të ekosistemit si dhe ndërtimit të një metodologjie dhe strategjie ndërshtetërore për ruajtjen e ekosistemit. Po kështu synohet rritja e kapaciteteve në nivel ndërshtetëror për sa i përket adresimit të vulnerabilitetit mjedisor, fragmentimit dhe ruajtjes të shërbimeve të ekosistemit në zonën Adriatike-Joniane.

Gjatë kësaj periudhe projekti ka organizuar takimin e parë të tij në prill 2018 me pjesëmarrjen e të gjithë partnereve në Staranzano të Italisë. Të gjithë partnerët kanë përzgjedhur zonën pilot, e cila do të shërbejë për hartëzimin dhe identifikimin e problematikave në biodiversitet dhe ekosistem. Liqeni i Shkodrës do të jetë zona pilot e përzgjedhur për territorin shqiptar.

Procesi i kontraktimit të dy konsulencave, Menaxheri i zonave të mbrojtura dhe Eksperti teknik shkencor, ka përfunduar dhe tashmë ka nisur puna për hartimin e produkteve të para që lidhen me hartëzimin e habitateve, specieve dhe grupeve të interesit.

Takimi i dytë e projektit u organizua në datat 26-28 shtator në Greqi, ku partneri pritës ishte Qarku Kretë. Gjatë takimit u diskutua për çështje të implementimit financiar dhe teknik të projektit, dhe u dakordësua për afatet e aktiviteteve të ardhshme të projektit.

Gjatë muajin Nëntor 2018 është dorëzuar raporti i dytë progresiv, financiar dhe narrativ i projektit pranë Ministrisë së Financave.

Ndërkohë gjatë tremujorit të katërt të viti 2018 është përfunduar raporti i ngritjes së Task Forcës së Përbashkët, e cila është një strukturë që do të përfshijë të gjithë aktorët e interesit duke bërë të mundur zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura, forcimin e partneritetit me aktorët e brendshëm dhe të jashtëm dhe promovimin e vlerave të zonave të mbrojtura.

Projekti “Blue BOOST”:

Rritja e potencialit të inovacionit të sektorëve tradicionale dhe atyre emergjentë të ekonomisë blu me tendencë rritje të shpejtë (Blue Growth) në zonën Adriatiko-Joniane

Buxheti i projektit:	1,338,941 Euro
Buxheti i projektit për FSHZH:	181,456 Euro
Kohëzgjatja:	22 muaj (Janar 2018 - Tetor 2019)
Financues:	Bashkimi Europian, Programi ADRION
Shtetet pjesëmarrëse:	Italia, Greqia, Kroacia, Shqipëria
Objektivi i projektit:	Rritja e potencialit të inovacionit të sektorëve tradicionale dhe atyre emergjentë të ekonomisë blu me tendencë rritje të shpejtë (Blue Growth) në zonën Adriatiko-Joniane.

Grupimet detare brenda zonës ADRION, karakterizohen nga një heterogjenitet aktivitetesh, një boshllëk në ndërveprimin në katër helikat respektive (qeveri, industri, trajnim dhe shoqëri) dhe një ambient me mungesë ndërveprimi sidomos në sektorin ndërsektorial.

BLUE BOOST ka si qëllim çlirimin dhe fuqizimin e potencialeve të njohurive dhe transferimit të teknologjive, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndërsektorial të aktorëve kyç në sektorët e ekonomisë blu duke fuqizuar marrëdhëniet dhe ndërveprimin brenda dhe ndërmjet grupeve të ngjashme, bazuar në një sistem shkëmbimi njohurish të hapur dhe të mbështetur në komunitet.

Qëllimi është të analizohen ndërthurje të mundshme ndërmjet sektorëve, ide dhe kompetenca të reja, aleanca dhe rrjete të reja midis individëve ose komuniteteve, ndërmarrjeve, organizatave dhe institucioneve të ekonomisë detare.

Gjatë kësaj periudhe është hartuar një studim në lidhje me ekonominë blu në katër zonat pilot të përcaktuara në projekt, dhe janë evidentuar sektorët premtues mbi të cilët do të mbështetet projekti. Takimi i parë i partnerëve të projektit në prill 2018 ndihmoi në sqarimin dhe saktësimin e aktiviteteve të parashikuara.

Ndërsa takimi i dytë i shoqëruar edhe nga një vizitë studimore me pjesëmarrjen e SME-ve, përfaqësuesve të sektorit të Akuakulturës, kontribuoi më shumë në riprogramimin e aktiviteteve të ardhshme si dhe vendosjen e urave bashkëpunimit midis SME-ve pjesëmarrëse nga të gjitha vendet e rajonit.

Aktiviteteve të ardhshme parashikojnë organizimin e Laboratoreve Blu (workshopeve të bazuara në analizën dhe evidentimin e problematikave të sektorëve të Ekonomisë Blu në të cilat fokusohet projekti), workshopeve të skenarëve (ku simulohen skenarë të përmirësimit dhe inovacionit për SME-të pjesëmarrëse) si dhe organizimi i Hackathoneve (që janë grumbullime 48 orëshe të përfaqësuesve të SME-ve për t'i dhënë zgjidhje një çështje apo problemi me të cilin ndeshen SME-të e një sektori të caktuar).

Projekti “InnoXenia”:

Inovacioni në Turizëm në rajonin e gjerë Adriatik - Jon

Buxheti i projektit:	1,055,190 Euro
Buxheti i projektit për FSHZH:	90,000 Euro
Kohëzgjatja:	15 muaj (Janar 2018 - Mars 2019)
Financues:	Bashkimi Europian, Programi ADRIION
Shtetet pjesëmarrëse:	Bosnjë-Hercegovina, Greqia, Italia, Kroacia, Shqipëria, Sllovenia
Objektivi i Projektit:	Përmirësimi i kapacitetit të inovacionit në sektorin e turizmit, duke u mbështetur në produkte, procese dhe shërbime të reja, që mund të plotësojnë ofertat turistike kulturore dhe natyrore të rajonit.

Projekti synon të përmirësojë kapacitetet inovative të sektorit të turizmit në zonën e Adriatikut dhe Jonit, duke u fokusuar kryesisht tek produktet, proceset dhe shërbimet inovative, që mund të mbështesin dhe t'u sjellin vlerë të shtuar pasurive natyrore dhe kulturore.

Gjatë gjashtëmujorit të parë është punuar për të siguruar të ardhmen e projektit, duke mbajtur në mënyrë të vazhduar komunikimin me të gjithë institucionet partnere, deri në finalizimin e procedurës së ndryshimit të partnerit lider. Krahas kësaj, është punuar për evidentimin e grupeve të interesit: institucione publike, biznese private, universitete dhe qendra kërkimore apo përfaqësues të shoqërisë civile, planifikimin e aktiviteteve kryesore, si dhe hartimin e planit të prokurimit dhe analizën fillestare të ekspertizave të nevojshme gjatë zbatimit të projektit.

Në korrik 2018, përfundoi procesi i nënshkrimit të Kontratës së Subvencionimit dhe Marrëveshjes së Partneritetit për këtë projekt. Gjithashtu, gjatë muajit gusht, u realizua në Greqi takimi i parë mes partnerëve të projektit, i cili shënoi edhe nisjen e zbatimit të projektit. Në këtë takim iu kushtua një vëmendje e veçantë rishikimit të planit të aktiviteteve, për të mundësuar realizimin në kohë të tyre. Menjëherë pas takimit të partnerëve nisi puna e stafit të projektit për përgatitjen e produkteve të para, përzgjedhjen e ekspertizave, fushatat informuese për projektin InnoXenia nëpërmjet rrjeteve sociale dhe takimeve informuese. Gjithashtu është punuar në drejtim të mbledhjes së informacionit lidhur me ekzistencën e të dhënave mbi turizmin gjatë 5 viteve të fundit, informacion ky mbi bazën e të cilit u realizua produkti i parë, si dhe përzgjedhja e destinacionit të projektit, Bashkia Përmet.

Gjatë tremujorit të katërt të këtij viti u organizua takimi i parë komunikues i projektit në Tiranë, në formën e një Kafaje Pune me tematikë “Inovacioni në Turizëm”, me pjesëmarrjen e përfaqësuesëve nga univeristete publike e private dhe qendra kërkimore nga qytete të ndryshme të Shqipërisë, të cilët patën mundësinë të njihen me projektin, si dhe të diskutojnë e të ndajnë eksperiencat e tyre mbi këtë temë e të angazhohen përgjatë gjithë fazës së implementimit të projektit. Pjesë e fushatës ndërgjegjëse të projektit, ishte edhe Konferenca Ndërkombëtare ERDF organizuar në Teramo, Itali. Implementimi i aktiviteteve të projektit vijoi me organizimin e Workshop-it TIDSS dhe Trajnimit të Trajnerëve për Mbledhjen dhe Hedhjen e të Dhënave, në Zadar, Kroaci, me pjesëmarrjen e të gjithë partnerëve.

Për sa i përket çështjeve financiare të projektit, gjatë kësaj periudhe janë realizuar dy raporte të plota dhe një raport i ndërmjetëm shpenzimesh, kanë përfunduar procedurat për marrjen e parafinancimit, si dhe ka përfunduar me sukses çertifikimi i shpenzimeve sipas raportimit të parë.

Projekti “Adrion 5 Senses”:

Krijimi i emrit tregtar ADRION në fushën e turizmit: nxitja dhe kënaqja e të 5 shqisave të turistëve

Buxheti i projektit:	1,437,076 Euro
Buxheti i projektit për FSHZH:	120,529 Euro
Kohëzgjatja:	24 muaj (Janar 2018 - Dhjetor 2019)
Financues:	Bashkimi Europian, Programi ADRION
Shtetet pjesëmarrëse:	Bosnjë-Hercegovina, Greqia, Italia, Kroacia, Mali i Zi, Serbia, Shqipëria, Sllovenia
Objektivi i Projektit:	Krijimi dhe promovimi i një modeli të qëndrueshëm turizmi, që ofron shërbime dhe produkte turistike inovative e të cilësisë së lartë dhe krijon përvoja gjithëpërfshirëse që kënaqin të 5 shqisat e turistëve.

Projekti synon hartimin e një strategjie të përbashkët dhe plani veprimesh për menaxhimin e destinacioneve të zonës Adrion, krijimin dhe promovimin e brendit “Adrion” me aktivitetet shoqëruese përkatëse si Harta e Ndjeshmërive, Platforma Web Shumëgjuhëshe, Qendrat e Ekspozimit, etj. Po kështu projekti synon vlerësimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të destinacioneve Adrion nëpërmjet marketimit të eksperiencave turistike 5 shqisore.

Takimi i parë mes partnerëve të projektit, i mbajtur në fund të muajit Qershor 2018, u parapri nga një punë përgatitore në drejtim të evidentimit të aktiviteteve kryesore,

identifikimit të institucioneve apo individëve të interesuar, përgatitjes së planit të prokurimit dhe analizës fillestare të llojit të ekspertizës së nevojshme gjatë zbatimit të projektit.

Është punuar për mbledhjen e informacionit lidhur me situatën turistike dhe përzgjedhjen e destinacionit të projektit, Alpet Shqiptare.

Gjatë tremujorit të fundit ka përfunduar procedura për përzgjedhjen e ekspertit të jashtëm për Kërkimin e tregut dhe Hartimin e Strategjisë Turistike. Është realizuar studimi i situatës turistike, identifikimi i praktikave më të mira dhe analiza benchmarking bazuar në guidat, pyetësorët dhe formularët e përgatitur nga partneri përgjegjës. Po punohet për hartimin e strategjisë turistike për rajonin e përzgjedhur.

Për sa i përket çështjeve financiare të projektit, gjatë kësaj periudhe janë realizuar dy raporte të plota dhe një raport i ndërmjetëm shpenzimesh, si dhe është finalizuar marrja e parafinancimit.

Projekti 4helix+ :

Fuqizimi i grupeve të interesit të zonave detare përmes një platforme të hapur elektronike për ndarjen e njohurive dhe qasjen në favor të komunitetit për zhvillimin e ekonomisë blu

Buxheti i projektit:	2,193,983 Euro
Buxheti i projektit për FSHZH:	169,705 Euro
Kohëzgjatja:	30 muaj (Shkurt 2018 - Korrik 2020)
Financues:	Bashkimi Europian, Programi Interreg MED (2014 - 2010)
Shtetet pjesëmarrëse:	Italia, Spanja, Franca, Portugalia, Greqia, Kroacia dhe Shqipëria.
Objektivi i Projektit:	Të stimulojë, trajtojë dhe financojë novacionin krijues në sektorin e Ekonomisë Blu në zonën e Mesdheut.

Projekti ka për qëllim të përmirësojë novacionin ndërsektorial dhe transkufitar të ekonomisë detare (Blue Growth), e cila meriton të mbështetet më së miri si një nxitës ekonomik dhe një gjenerator i mundshëm i zhvillimit dhe i vendeve të punës.

Projekti ka organizuar mbledhjen e parë të tij në prill 2018 me pjesëmarrjen e të gjithë partnereve ku u diskutuan çështjet teknike dhe menaxhimit financiar të projektit. Është bërë një hartëzim dhe analizë e situatës aktuale të ekonomisë blu në rajonet e përzgjedhura të projektit ku janë përzgjedhur sektorët më aktivë. Ndërkohë, ka nisur puna për hartimin e kriterëve të përzgjedhjes për ekspertët e fushës së ekonomisë blu (knowledge providers), të cilët do të shpallen në platformën elektronike të projektit.

Në muajin korrik të këtij viti u organizua mbledhja e dytë e projektit në Lisbonë. Takimi intensiv dy-ditor trajtoi në detaje pjesën më të madhe të eventeve dhe aktiviteteve të projektit për fazën e ardhshme në lidhje me Blue Bootcamps, Ditëve Rajonale, si dhe aktivitete kryesore të projektit, që do të zhvillohen për përgatitjen e Thirrjes së Voucher për Inovacionin e kompanive të sektorit detar.

Në muajin Dhjetor u kontraktuan ekspertët, të cilët kanë nisur aktivitetin për identifikimin e bizneseve përfituese të lokalizuara në katër zonat pilot të projektit, si dhe adresimi i nevojave të tyre nëpërmjet hartimit të pyetësorëve të cilat do t'i

shpëndohen jo vetëm aktorëve lokal, por edhe atyre rajonal. Në platformën elektronike të projektit është shpallur gjithashtu thirrja për ekspertë që i përkasin Industrisë Kulture Kreative dhe Inovacionit (Knowledge Providers).

Fituesit e përzgjedhur do jenë pjesë e aktiviteteve të ardhshme të projektit në rolin e konsulentit të bizneseve që i përkasin sektorit “blu”.

Në terma administrative është dorëzuar raporti i parë progresiv, financiar dhe narrativ i projektit pranë Ministrisë së Financave.

Projekti “ViP Dinarica”:

“Zgjatimi i ViP DinaricA në zonën ndërkufitare Shqipëri Kosovë”

Buxheti i projektit:	444,684 Euro
Buxheti i projektit për FSHZH:	220,000 Euro
Kohëzgjatja:	24 muaj (Mars 2018 - Mars 2020)
Financues:	Bashkimi Europian, Programi CBC Shqipëri-Kosovë (2014 - 2020)
Shtetet pjesëmarrëse:	Shqipëria dhe Kosova.
Objektivi i Projektit:	Të fuqizojë zhvillimin ekonomik ndërkufitar nëpërmjet modeleve unike të turizmit të qëndrueshëm të bazuar në vlerat natyrore, tradicionale dhe kulturore duke vënë në dukje karakteristikat e përbashkëta të zonës

Seksioni Via DinaricA, është një vazhdim i koncepteve të mëparshme të Via Dinarica dhe Majave të Ballkanit që ndërlidhin Bosnjë-Hercegovinën, Malin e Zi, Kosovën dhe Shqipërinë me më shumë se 1,000 km shtigje të pandërprera në distanca të gjata. Rrugët e reja Via DinaricA që lidhin shtigjet e ecjes dhe çiklizmit me Shqipërinë dhe Kosovën, përshkajnë parqet kombëtare Bjeshkët e Nemuna, Komunat e Gjakovës, Deçanit, Junikut, Pejës dhe Shqipërisë, Bashkitë e Qarkut të Kukësit. Projekti synon zhvillimin më tej të vlerave turistike të komunitetit rural malor të zonave ndërkufitare të Shqipërisë dhe Kosovës, dhe u jep mundësi vizitorëve që të njihen me traditat e jetesës gjatë udhëtimit që përshkron shtegu Via DinaricA, duke eksploruar natyrën, historinë dhe kulturën e rajonit.

Në fund të muajit maj 2018, u organizua në qytetin e Bajram Currit, takimi i hapjes i projektit me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve, organizatave, individëve të interesuar nga Shqipëria dhe Kosova. Gjatë kësaj periudhe është punuar në përgatitjen e një raporti i cili përcakton gjurmën e shtigjeve të parashikuara nga projekti për ecje në natyrë dhe ecje me bicikletë. Materiali i hartuar përmban edhe sugjerime mbi vendet ku do të ndërtohen dy ballkone panoramike. Një tjetër aktivitet i organizuar gjatë kësaj periudhe ishte trajnimi i organizuar për markimin e shtigjeve në të cilin morrën pjesë përfaqësues të shoqatave të ecjes në natyrë dhe të biçiklistëve.

Gjatë muajit shtator u realizua në Gjakovë, Kosovë trajnimi për udhëzuesit e grupeve të biçiklistëve. Ky ishte një aktivitet tregues ku u kombinua mjaft mirë pjesa teorike me atë praktike.

Në muajin tetor është organizuar Turi familjarizues ku përfaqësues të organizatave, shoqatave, agjensive që organizojnë udhëtime në natyrë u njohën me itinerarin e Via Dinarica në Kosovë, vende dhe objekte të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, restorante të mbështetura në traditën e zonës etj.

Gjatë muajit Nëntor është përgatitur programi i FAM Tour që do të realizohej në Shqipëri por si pasojë e kushteve atmosferike u shty për më tej.

Gjatë muajit Dhjetor është përgatitur dhe realizuar në Kukës, takimi i dytë i grupit drejtues të projektit ku u shqyrtuan raportet e përgatitura mbi shtigjet, aktivitetet e deritanishme dhe u diskutua mbi aktivitetet e ardhshme të projektit.

Projekti:	FILA - Fertilization and Innovation Labs in Agro-food
Buxheti i projektit:	1.044.547,80 EUR
Buxheti për AZHR3:	176.798,75 EUR
Kohëzgjatja:	24 muaj (01.04.2018 - 31.03.2020)
Financues:	Interreg IPA CBC Itali - Shqipëri - Mali i Zi, (2014 - 2020)
Shtetet pjesëmarrëse:	Itali, Shqipëri, Mali i Zi
Objektivi i Projektit:	Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe konkurrencës së SME-ve.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është krijimi në rang ndërkufitar i laboratorëve FILA që janë “ambjente inovacioni” ku do të favorizohet bashkëpunimi midis aktorëve të sistemit të inovacionit (biznese të vogla të mesme, organizata që mbështesin bizneset, qendra kërkimore, investitorë) për të përmirësuar aksesin në proceset kërkimore dhe në rezultatet e sipërmarrjeve, pra për të stimuluar kërkimin e zgjidhjeve inovative dhe investime të mëtejshme në inovacion si dhe për të mbështetur strat-up-e.

Në kuadër të implementimit, të projektit FILA, përgjatë periudhës raportuese janë kryer të gjitha procedurat administrative të nevojshme për reflektimin e ndryshimit të partnerit nga ish AZHR3 tek FSHZH. Gjithashtu janë analizuar burimet njerëzore të nevojshme për t'u përfshirë si staf i angazhuar në projekt si dhe është përgatitur dokumentacioni përkatës për të kryer raportimin e periudhës nr 2 (Korrik-Dhjetor 2018). Gjatë muajit Dhjetor, stafi i projektit morri pjesë në takimin e partnereve të projektit, organizuar nga AIDA ku u diskutua plani i rifreskuar i aktiviteteve, plani i prokurimeve si dhe problematika të tjera të hasura përgjatë zbatimit të projektit. Gjatë muajve Nëntor-Dhjetor janë identifikuar aktorët si dhe ka filluar puna përgatitore për përgatitjen e termave të referencës për kontraktimit e ekspertëve në agro-ushqim dhe inovacion.

Projekti:	Standardet dhe Çertifikimi i produkteve bujqësore, Ngritja e Kapaciteteve në përthithjen e Fondeve dhe Strategjitë e Marketingut në Mbështetje të Rritjes Ekonomike dhe Tregtisë të Agrobizneseve
Buxheti Total i projektit:	310,000 EUR
Buxheti për AZHR2:	80,923 EUR
Kohëzgjatja:	24 muaj (30.11.2017- 30.11.2019)
Financues:	Programi i bashkëpunimit ndërkufitar Maqedoni-Shqiperi (IPA2) 2014-2015
Shtetet pjesëmarrëse:	Shqipëri, Maqedoni
Objektivi i Projektit:	Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve

Objektivi kryesor i projektit është të çertifikojë prodhuesit dhe përpunuesit në nën-sektorë si përpunimi i mishit, qumështit dhe nën-produkteve të tij, Frutave &

Perimeve dhe Bimëve Medicinale me katër tipe certifikatash të sigurisë ushqimore të njohura në nivel ndërkombëtar. Projekti do të synojë nxitjen e tregtisë në tregjet e Bashkimit Europian dhe rritjen e produktivitetit të sipërmarrjeve bujqësore përmes zhvillimit të kapaciteteve të brendshme (prodhuese, menaxhuese, marketing etj). Gjatë kësaj përudhe ka vijuar puna për zbatimin e projektit. Në datat 21-23 Nëntor, në Peshkopi u zhvillua aktiviteti i trajnimit me temë “Thirrja e parë për aplikime në skemat e fondeve IPARD për Agrobiznesin”, ku morrën pjesë rreth 80 fermerë dhe agro-përpunues, të cilët u njohën me skemat dhe procedurën e financimit të IPARD. Gjithashtu është vijuar me certifikimin subjekteve rreth standarteve të sigurisë ushqimore sipas praktikave më të mira ndërkombëtare.

Projekti:	Co.Co.Tour. Ruajtja, rritja dhe promovimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore të komuniteteve bregdetare nëpërmjet nxitjes së modelit të eko-muzeut me qëllim menaxhimin e zgjuar dhe të qëndrueshëm të turizmit.
Buxheti Total i projektit:	1,079,523 EUR
Buxheti për AZHR4:	183,948 EUR
Kohëzgjatja:	24 muaj (03.04.2018-02.04.2020)
Financues:	Programi i bashkëpunimit ndërkufitar IPA CBC “Itali-Shqipëri-Mal i Zi”
Shtetet pjesëmarrëse:	Shqipëri, Mal i Zi, Itali
Objektivi i Projektit:	Menaxhimi i zgjuar i trashëgimisë natyrore dhe kulturore për shfrytëzimin e turizmit të qëndrueshëm ndërkufitar dhe atraktivitetit territorial.

Ky projekt ka si objektiv të garantojë një përfshirje të zgjuar dhe një rritje të qëndrueshme të komuniteteve bregdetare në zonat e targetuara nëpërmjet zhvillimit të një modeli ndërkufitar eko-muzeumi dhe të një strategjie të përbashkët të fokusuar në konceptin “turizmi në komunitet”. FSHZH është në pozicionin e partnerit kryesor dhe ka për detyrë koordinimin e partnereve, aktivitetete si dhe menaxhimin financiar të gjithë projektit. Gjatë periudhës raportuese janë ndjekur të gjitha procedurat administrative që lidhen me ndryshimin zyrtar të partnerit kryesor. Gjatë muajit Shkurt do të organizohet një takim në Tiranë më të gjithë partnerët me qëllim identifikimin e problematikave dhe hasura sqarimin e paqartësive dhe aprovimin e planit të rifreskuar të aktiviteteve apo çështje të tjera teknike dhe të menaxhimit financiar.

Projekti:	Complete
Buxheti Total i projektit:	631,435 EUR
Buxheti për AZHR4:	153,913 EUR
Kohëzgjatja:	24 muaj (26.03.2018-26.03.2020)
Financues:	Programi i bashkëpunimit ndërkufitar IPA CBC “Greqi-Shqipëri 2014-2020”
Shtetet pjesëmarrëse:	Shqipëri, Greqi
Objektivi i Projektit:	Mbështetje në rritjen e ekonomisë lokale

Ky projekt ka si objektiv të mbështesë sipërmarrjen dhe të rrisë konkurrueshmërinë e SME-ve të përfshira në sektorin blegtoral përmes inovacioneve të aplikuara në kujdesin shëndetësor të kafshëve dhe në sipërmarrjen e fermave të gjësë së gjallë. Në të njëjtën linjë si projektet e tjera të bashkëpunimit ndërkufitar të cilat janë të mbartura nga ish agjencitë e zhvillimit rajonal, është vijuar me procedurat e

ndryshimit të partnerit. Është emëruar stafi i projektit si dhe është përditësuar plani i prokurimeve dhe i aktiviteteve.

Gjatë muajve në vijim do të hartohen termat e referencës për kontraktimin e ekspertizës së nevojshme për vijimin e zbatimit të projektit.

8. Projekti “Pastrimi i kanaleve kulluese në Shkodër dhe Fier”

Buxheti: 120 000 Eur

Kohëzgjatja: 1 Tetor 2018 - 30 Nëntor 2018

Financues: Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Objektivi i Projektit: Pastrimi i kanaleve kulluese në zonat më të riskuara nga përmbytjet në Shkodër dhe Fier.

Ky objektivi u arrit përmes pastrimit dhe trajtimit të kanaleve kulluese në disa njësi administrative problematike në qytetet e Shkodrës dhe Fierit duke efektuar ekonominë e zonës prej punësimit të personave me të ardhura të ulta dhe emigrantëve të kthyer. Për këtë qëllim në bashkëpunim me Bashkitë Shkodër dhe Fier, u përzgjedhën njësitë administrative Ana e Malit, Guri i Zi, Bërdicë, Rrethina, Velipojë, Dajç dhe Shkodër qytet për Shkodrën dhe njësitë administrative të Frakullit dhe Levanit për Fierin.

Për punimet, shumica e 200 punëtorëve të punësuar për harkun dy-mujor ishin banorë të zonave. Kjo garantoj injektim në ekonominë lokale të buxhetit të projektit, përpos efektit pozitiv të pastrimit të kanaleve kulluese me qëllim minimizimin e efekteve të sezonit të rreshjeve.

9. Përgatitja dhe aplikimi për programe të reja

Një nga shtyllat e aktivitetit të FSHZH është programimi bazuar në analizën reale të nevojave, potencialeve që gjenerojnë impakt në zhvillim, duke vijuar më tej me gjetjen e burimeve të financimit, aplikimin pranë donatorëve, sigurimin e fondeve për financim dhe gjithë përgatitjet e nevojshme për të siguruar kalimin nga programimi në fazën e zbatimit të projekteve. FSHZH ka vijuar procesin e programimit të projekteve si më poshtë:

9.1 Programi për Zhvillimin e Integruar të Zonave me Potencial Turistik

Programi parashikon investime strategjike rajonale në zonat me potencial turistik në Bashkitë e Shkodrës, Korçës, Fierit, Beratit. Programi do të financohet nga BERZH dhe IPA me vlerë të pritshme financimi 100 milionë Euro. Ky program është në fazë programimi dhe parashikohet të ketë kohëzgjatje 4 vjeçare. Pritet konkludimi i marrëveshjeve mes BERZH e Komisionit European si dhe Qeverinë Shqiptare për të mundësuar fillimin e zbatimit të programit nga FSHZH.

Në kuadër të këtij programi, FSHZH aplikoi dhe fitoi një grant të WBIF përmes BERZH që mundëson vazhdimin e studimit të Bregut Perëndimor të Liqenit të Shkodrës, pra vazhdimin e projektit të rivitalizimit të Shirokës, për ta vijuar këtë nismë deri në kufi, përfshirë dhe Zogaj, me synim hapjen e kufirit në këtë zonë dhe bashkëpunimit me Malin e Zi. Vlera e grantit është 400 mijë Euro dhe implementohet gjatë periudhës 2018 - 2019. Konsulenca është mobilizuar pritjet dorëzimi i Inception Report.

9.2 Projekti Porta bregdetare e Alpeve

Projekti në vlerën 2.5 milion Euro, fokusohet në bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe dhe Lezhë dhe specifikisht në zonën liqenore të Liqenit të Shkodrës, në fashën lumore të Bunës si dhe në bregdetin Adriatik të Velipojës dhe Shëngjinit. Janë hartuar termat e referencës dhe pritet nënshkrimi i marrëveshjes ndërmjet BEI dhe Ministrisë së Financave. Projekti përfshin zonat urbane por gjithashtu edhe zonat natyrore dhe mjedisore të këtyre bashkive. Projekti “Gate of Alps” ka dy komponentë kryesorë; atë të studimit të integruar urban dhe turistik të zonës si dhe përgatitjen e projekteve teknike specifike për zonën. Lidhur me këtë projekt janë finalizuar termat e referencës për hartimin e studimit të kësaj zone si dhe është përgatitur dosja e prokurimit për komponentin e parë.

9.3 ALMONIT-MTC (Albania, Montenegro, Italy - Multimodal Transport Connectivity)

Buxheti i projektit: 7 mln Eur

Buxheti për FSHZH: 2.94 mln Eur

Kohëzgjatja: 42 muaj (2019-2022)

Financues: Interreg IPA CBC Itali - Shqipëri - Mali i Zi, (2014 - 2020)

Shtetet pjesëmarrëse: Itali, Shqipëri, Mali i Zi

Objektivi i Projektit: Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet vendeve pjesëmarrëse.

Ky objektivi pritet të arrihet përmes krijimit të një rrjeti lëvizjeje ndërmjet shteteve pjesëmarrëse, përkatësisht Shqipëria, Mali i Zi dhe rajonet e Puglias dhe të Molises, Itali. Ndërmjet krijimit të transportit multimodal, ku përfshihet krijimi i linjave të reja detare dhe zhvillimi i Liqenit të Shkodrës, pritet të rritet jo vetëm lidhshmëria, por edhe ndërveprimi ndërmjet vendeve të Adriatikut të ulët. Me anë të aktiviteteve që do të ndërmerren nga projekti, shtetasit e vendeve pjesë e projektit si edhe vizitorët e shumtë të këtyre vendeve turistike, do të përfitojnë nga një lidhshmëri inovative, multimodale dhe efikase.

9.4 Programi i investimeve për zhvillim të integruar rajonal

Programi parashikon ndërhyrje infrastrukturore të integruara në funksion të nxitjes së zhvillimit ekonomik të zonave me potencial turistik, si rrugë, sheshe e shëtitore, hapsira rekreacioni dhe sportive. Programi bashkëfinancohet nga Qeveria Gjermane, ku parashikohet që faza e I-rë të financohet mes një kredie të butë të KfW në vlerë të përgjithshme deri në 20 milionë euro dhe bashkëfinancim nga Qeveria Shqiptare për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikqyrjen e projektit në vlerë të përgjithshme deri në 1 milion euro.

Programi ka filluar fazën e konceptimit dhe programimit në vitin 2018 dhe pritet të përfundojë zbatimin e fazës së parë në vitin 2022.

Pas misionit të një konsulence të kontraktuar nga KfW e kryer në muajin qershor 2018 dhe raportit të dorëzuar në muajin Tetor pranë Qeverisë Gjermane u vendos sa më poshtë:

Përsa i përket bashkisë së Durrësit zona makro e ndërhyrjes shtrihet nga Ura e Dajlanit deri në Qerret por në fazën e parë programi do të përqëndrohet në zonën e Kavalishencës. Nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje, sot, zona e Kavalishencës e paaksesushme nga banorët dhe turistët do të kthehet në një hapësirë publike e

pasuruar me aktivitete të aksesueshme nga të gjithë. Lidhur me këtë ndërhyrje ka mbaruar faza konceptuale dhe po përgatiten vizatimet teknike për të shkuar drejt një maturimi të plotë të projektit.

Përsa i përket ndërhyrjeve në bashkinë e Pogradecit si zonë ndërhyrjeje është përcaktuar zona e vijës liqenore në qytetin e Pogradecit deri në fshatin Tushemisht. Projekti është ende në fazë konceptuale e përgatitur kjo nga FSHZH dhe maturimi i tij nuk ka nisur ende.

Përfshirja e bashkisë së Himarës në këtë program është në diskutime përsa i përket zonës dhe llojit të ndërhyrjes.

10. AKTIVITETI INSTITUCIONAL

10.1 Menaxhimi Financiar

Analiza financiare për vitin 2018, bazuar në sistemin raportues të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, jep informacion kryesisht mbi funksionet kryesore financiare: planifikimin, kontabilitetin, menaxhimin financiar të investimeve dhe atë operativ-administrativ.

Gjatë vitit 2018, janë bërë përpjekje për ruajtjen dhe garantimin e ekuilibrave financiarë të institucionit në mënyrë që i gjithë aktiviteti ekonomik-financiar të jetë i organizuar brenda limiteve të lejuara të financimit. Gjithashtu vëmendje i është kushtuar administrimit dhe menaxhimit të fondeve me përgjegjshmëri dhe transparencë, si dhe monitorimit dhe mbikqyrjes së detajuar të fondeve sipas komponentëve përkatës: investime në infrastrukturë, administrim i brendshëm, asistencë teknike, etj.

Në zbatim të VKM 438 datë 18.07.2018 “Për kalimin e funksioneve të Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal (AKZHR), Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik Rajonal (AZHER) dhe agjencive të zhvillimit rajonal (AZHR), pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit”, nga data 01.08.2018 stafi dhe gjithë shpenzimet këtyre agjencive kaluan në FSHZH.

Buxheti faktik për vitin 2018 per Fondin Shqiptar të Zhvillimit në zbatim të Akteve Normative Nr. 1 datë 26.07.2018 dhe Nr.2 datë 19.12.2018 është në vlerën 16,846 milione Leke ose rreth 133 milionë Euro.

Gjatë vitit 2018 realizimi është në masën 95 % ose rreth 125.6 milionë Euro. Më poshtë tabela e realizimit për çdo kategori të zerave të buxhetit.



Realizimi i Buxhetit për vitin 2018

Kategoria	Totali i Përgjithshëm		
	Buxheti vjetor (Euro)	Realizimi 2018 (Euro)	%
Punime Civile	123,602,615	118,874,640	96%
Design&superv.	4,262,064	3,041,198	71%
Asistence Teknike	979,371	785,927	80%
Training	219,504	52,035	24%
Investime &PaisjeFZSH	752,930	501,807	67%
Kosto Operative	2,678,381	2,345,785	88%
Rezerve	43,668	-	-
T o t a l i	132,538,533	125,601,392	95%

Investimet në infrastrukture gjatë kësaj periudhe janë realizuar në masën 118.9 milionë Euro ose rreth 96 % e buxhetit të faktik.

Në këte zë janë përfshirë rreth 53.8 milionë Euro investime në kuadër të FZHR-së, të cilat janë transferuar përmes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në institucionet vendore dhe qendrore për financimin e projekteve në vazhdim të investimeve në kuadër të Programit Infrastruktura Vendore dhe Rajonale 2014-2017.

Në datë 26.07.2018, është dërguar për miratim në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, rialokimi nr. 3 FZHR me vlerë 4.8 milionë Euro.



Pasqyrat financiare që paraqiten më poshtë, përmbajnë të dhëna të cilat krijojnë një skenar të qartë të mjedisit ekonomiko-financiar dhe të performancës së aktivitetit të FSHZH-së, si dhe një analizë në nivelin strukturor të shpenzimeve dhe të të ardhurave duke paraqitur në këtë mënyrë raportin si dhe peshën specifike të donatorëve, kategorive dhe komponentëve të veçantë gjatë këtij viti.

Gjatë vitit 2018 janë përgatitur Pasqyrat Financiare Vjetore (Bilanci) për vitin 2017 dhe në 13.03.2018 janë dërguar në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë sipas formatit dhe standarteve të kërkuara.

Lidhur me auditin e jashtëm për vitin 2017, në bashkëpunimin me zyrën juridike janë përgatitur ToR dhe është dërguar shkresa shoqëruese në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë e cila kryen procesin e përzgjedhjes së kompanisë. Aktualisht pas komunikimeve me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, ende nuk është përzgjedhur kompania e cila do të kryejë auditimin për vitin 2017.

Në muajin Maj 2018 është dorëzuar pranë Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë PBA 2019 - 2021 faza e parë, e cila është përgatitur sipas kërkesave buxhetore të institucionit si dhe në zbatim të udhëzimit 7/1 datë 28.02.2018. Ndërkohë dhe PBA 2019 - 2021 faza e dytë, është dorëzuar në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë brenda muajit Gusht 2018, sipas afateve të përcaktuara në udhëzimin e mësipërm. Gjatë tremujorit të tretë, FSHZH ka qënë në proces auditimi nga dy grupe të Kontrollit të Lartë të Shtetit për Programin “Fondi i Investimeve Sociale IV” financiar nga KfW për të gjithë periudhën e zbatimit të programit si dhe për procesin e transferimit të Programit “Infrastruktura Vendore dhe Rajonale/FZHR” nga MZHU në FSHZH.

Gjatë vitit 2018, FSHZH ka raportuar periodikisht pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Integritit dhe institucioneve të tjera sipas kërkesave lidhur me:

- Monitorimin e investimeve publike etj;
- Disbursimet dhe shpenzimet sipas programeve dhe donatorëve respektivë;

Gjithashtu janë dërguar raporte periodike tek Banka Botërore, KfW dhe CEB në përputhje me formatet sipas marrëveshjeve respektive.

Gjatë vitit 2018, FSHZH ka menaxhuar fondet e akorduara nga donatorët e huaj, Qeveria Shqiptare dhe Fondi për Zhvillimin e Rajoneve.

Aktualisht FSHZH ka në ndjekje financiare këto programe:

- Programi PK IV, “Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonave Bregdetare”, financiar nga CEB, WBIF dhe Qeveria Shqiptare;
- Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III”, financiar nga KfW, IPA 2013, WBIF, Qeveria Shqiptare dhe përfituesit e drejtpërdrejtë;
- Programi “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”, financiar nga Fondi Kuvajtian, Fondi Saudit dhe Qeveria Shqiptare;
- Programi “Për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin”, financiar nga Banka Botërore;
- Programi “Rrugët Dytësore dhe Lokale” financiar KfW & IPA 2009;
- Programi “Rrugët Lidhëse Rurale dhe Rajonale” financiar nga Banka Botërore;
- Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale IV” - Himara financiar nga KfW;
- Programi IPA Adrion, Intereg-Med dhe Vip Dinarica CBC - Kosovo;
- Programi Infrastruktura Vendore dhe Rajonale në kuadër të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, ku institucioni është përcaktuar në rolin e Sekretariatit Teknik;
- Programi për Rehabilitimin e Segmenteve Rrugore Prioritare financiar nga Qeveria Shqiptare;

Disbursimi i Fondeve gjatë vitit 2018, sipas programeve

Gjatë vitit 2018, FSHZH ka menaxhuar fondet e akorduara nga donatorët e huaj, Qeveria Shqiptare si dhe Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.

Për periudhën Janar - Dhjetor 2018, në kuadër të programeve me financim të huaj janë disbursuar rreth 21.05 milionë Euro respektivisht për secilin program si më poshtë:

- Programi Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III, janë disbursuar nga KfW 534 mijë Euro; IPA Grant 525 mijë Euro si dhe KfW Grant Himara 750 mijë Euro;
- Programi “Për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin” janë disbursuar nga Banka Botërore 2.4 milion Euro;

- Programi “Vip Dinarica” janë disbursuar 100 mijë Euro; Impreco 9.5 mijë Euro, Blue Boost 13 mijë Euro dhe IPA Hera 107 mijë Euro; Adrion 5 Senses 10.25 mijë Euro; 4 Helix 14.4 mijë Euro si dhe nga Programi i Standarteve të Produkteve Bujqesore financuar nga IPA 10.30 mijë Euro;
- Programi PK IV, “Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonave Bregdetare”, janë disbursuar nga CEB/kredi/Grant rreth 10.5 milionë Euro;
- Programi “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës” janë disbursuar nga Fondi Kuvajtian rreth 6.02 milion Euro;
- Programi i Rrugeve Dytesore dhe Lokale janë disbursuar nga KfW SIF IV 65 mijë Euro;

Fondet e akorduara nga Qeveria Shqiptare:

- Për programet me financim të huaj si bashkëfinancim për Kosto lokale dhe TVSH janë disbursuar rreth 11.6 milionë Euro si dhe rreth 999 mijë Euro nga përfituesit për investime;
- Për Programin Rehabilitimi i Segmenteve Rrugore Prioritare, financuar nga Qeveria Shqiptare janë disbursuar rreth 40.7 mln Euro;
- Për Programin e Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale të financuar nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, janë disbursuar rreth 54 mln Euro sipas projekteve në zbatim për periudhën 2014-2017 në Bashkitë dhe njësitë e qeverisjes qëndrore respektive.

Të ardhura të tjera

Gjatë aktivitetit ekonomiko-financiar të saj, FSHZH realizon të ardhura në vlera monetare nga aktivitetet dytësore si shitja e dokumentave të tenderit, interesa depozite me afat, konfiskime garancish etj. Gjatë vitit 2018, janë arkëtuar rreth 46 mijë Euro të ardhura nga shitja e dokumentave për tender dhe interesa bankare si dhe 90 mijë Euro nga konfiskim garanci oferte.

Shpenzimet dhe Realizimi i Zërave të Buxhetit për vitin 2018


Gjatë vitit 2018, FSHZH ka menaxhuar një fond prej rreth 125.6 milionë Euro, me një realizim financiar në masën 95 % kundrejt buxhetit faktik. Realizimi financiar paraqitet më poshtë i ndarë sipas komponentëve:

Infrastruktura

Ky zë përbën aktivitetin kryesor të institucionit dhe përfaqëson investimet në infrastrukturë për punime civile për rikonstruksion dhe përmirësim të infrastrukturës rrugore, gjelbërim të infrastrukturës rrugore dhe objekteve të tjera, rehabilitim të zonave urbane, rehabilitim dhe ndërtim të ujësjellësave ruralë, restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe të tjera. Investimet gjatë këtij viti janë realizuar në masën 118.9 milionë Euro ose rreth 96 % e buxhetit faktik. Gjatë vitit kanë qenë në proces financimi rreth 62 kontrata punimesh të menaxhuara nga FSHZH si dhe janë transferuar në njësitë e qeverisjes vendore dhe qëndrore rreth 53.8 milionë Euro për financimin e rreth 160 kontratave për investime në kuadër të Programit Infrastruktura Vendore dhe Rajonale.

Realizimi financiar për periudhën Janar - Dhjetor 2018 për kategorinë “Investime”

Programet	Pesha specifike në % kundrejt realizimit	Realizimi në vlerë (Euro)
PK IV Zhvillimi.Alp.Shqiptare Zona Bregdetare CEB	6.30%	7,488,239
Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës Fondi Kuvajtian	4.53%	5,384,628
Programi për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin BB	1.35%	1,602,492
Programi i Rrugeve Dytësore dhe Lokale KfW	0.02 %	21,925
Investime Qeveria Shqiptare+TVSH+FZHR	87.82%	104,377,356
Totali	100%	118,874,640



Projektim - Supervizimi

Gjatë këtij viti ky zë është realizuar në vlerën rreth 3,041 mijë Euro ose 71 përqind kundrejt buxhetit faktik dhe përfshin shpenzime për projektim dhe supervizion të punimeve civile sipas programeve përkatëse. Në kuadër të Programit PK IV, “Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonave Bregdetare” janë financuar nga CEB rreth 182 mijë Euro, në kuadër të Programit “Për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin”, janë financuar nga Banka Botërore rreth 509 mijë Euro, në kuadër të Programit Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III janë financuar nga KfW rreth 927 mijë euro për hartimin e projekteve të ujësjellësave, në kuadër të Programit “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës” janë financuar nga Fondi Kuvajtian rreth 640 mijë Euro për supervizion të punimeve, në kuadër të Programit Rrugët Dytësore Lokale rreth 43 mijë Euro për mbylljen e kontratës së supervizionit. Në kuadër të Programit Zhvillimi i Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale janë disbursuar rreth 405 mijë Euro për supervizion, kolaudim dhe “Mbështetje për hartimin/zhvillimin e planeve studimore dhe studime/projekte për bashkëfinancim me donatorë, (ndërvendorë, rajonale, etj)”. Gjithashtu, rreth 335 mijë Euro janë disbursuar për

supervizion dhe kolaudim për Programin Segmente Rrugore Prioritare, për hartim projektsh për Programin Rrugët Lidhëse Rurale dhe Rajonale e projekte të tjera, si dhe për projektim dhe supervision si bashkëfinansim i qeverisë shqiptare për programet me financim të huaj.

Asistenca Teknike

Gjatë këtij viti ky zë është realizuar në vlerën rreth 786 mijë Euro ose 80 përqind kundrejt buxhetit faktik dhe përfshin disbursime për Programin e ri Furnizimi me Ujë i Zonave IV-Himara, në vlerën 750 mijë Euro për përgatitjen e fizibilitetit për gjithë programin, si dhe 36 mijë Euro në kuadër të programeve IPA Adrion dhe Interreg Med.

Kualifikime

Gjatë këtij viti ky zë është realizuar në vlerën rreth 52 mijë Euro ose 24 përqind kundrejt buxhetit të miratuar dhe përfshin shpenzime kryesisht për pjesëmarrje në takime me përfaqësuesit e programeve IPA Adrion, Interreg Med dhe VIP Dinarica Kosova, trajnime të stafit brenda vendit dhe pjesëmarrje në konferenca dhe udhëtime studimore për rritjen e fondeve dhe gjetjen e donatoreve të rinj etj.

Investime dhe pajisje

Gjatë këtij viti në këtë komponent janë disbursuar rreth 501 mijë Euro, nga të cilat në kuadër të Programit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin rreth 385 mijë euro janë disbursuar për blerjen e pajisjeve/makinerve për mbledhjen e mbetjeve të ngurta për bashkitë e Himarës, 63 mijë Euro për pajisje elektronike si kompjutera, printera, fotokopje për institucionin dhe njësinë PCU. Gjithashtu rreth 53 mijë Euro janë disbursuar nga fonde IPA dhe kosto lokale për blerje kondicionerë dhe pajisje elektronike për institucionin.

Shpenzime operative

Shpenzimet operative gjatë këtij viti janë realizuar në vlerën 299 milionë Lekë ose rreth 88 përqind kundrejt buxhetit faktik.

Realizimi i zërave të shpenzimeve të kësaj kategorie kundrejt buxhetit vjetor është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Realizimi i kostos operative kundrejt buxhetit faktik 2018

Analiza e shpenzimeve të kostos operative

REALIZIMI KUNDREJT BUXHETIT 2018 (Kosto operationale) Lekë				
Nr.	Zërat	Buxhet 2018	Realizimi 2018	Përqindja e Realizimit
1	Kanceleri	4,880,000	2,596,389	53%
2	Karburant	13,000,000	9,166,093	71%
3	Servis makinash/siguracion	8,750,000	7,424,630	85%
4	Pagat	262,470,000	243,908,384	93%
5	Dieta	6,580,000	5,764,752	88%
6	Telefon dhe PT	3,100,000	1,788,029	58%
7	Internet	1,200,000	1,133,551	94%
8	Energji Elektrike/Ujë	3,500,000	2,150,007	61%
9	Zyra me qera	6,275,000	4,506,479	72%
10	Mirembajtje/Sigurim godine	6,470,000	4,445,606	69%
11	Te tjera/Petty cash	10,347,000	7,189,915	69%
12	Publikimi & Promovime	6,500,000	4,656,290	72%
13	Kontrata Sherbimi	3,610,000	1,820,015	50%
14	Shp. gjyqesore/perkthime	3,700,000	1,774,672	48%
15	Servis kompjuter dhe fotokopje	700,000	694,113	99%
	TOTAL	341,082,000	299,018,925	88%

a. Shpenzimet për kancelari

Shpenzimet kryesore në këtë zë janë kryesisht për kancelari të ndryshme, letër, bojra për fotokopje dhe printera, etj. Gjatë këtij viti janë shpenzuar rreth 2.59 milionë lekë ose 53 % e buxhetit faktik për blerje materiale zyre dhe kancelarie.

b. Shpenzimet për karburant

Buxheti vjetor për këtë zë të shpenzimeve është 13 milionë Lekë. Gjatë këtij viti janë shpenzuar rreth 9.16 milion Lekë ose 71 përqind e buxhetit faktik për blerje karburanti sipas kontratës vjetore.

c. Shpenzimet për mirëmbajtje dhe siguracion të automjeteve

Këto shpenzime përfshijnë shërbimet periodike, shërbimet e veçanta, blerjen e pjesëve të këmbimit, gomave dhe siguracionin e mjeteve. Buxheti i parashikuar për këtë zë është rreth 8.75 milionë lekë. Realizimi gjatë këtij viti është rreth 7.42 milionë lekë ose në masën 85 përqind të buxhetit faktik.

d. Shpenzimet për paga, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore

Shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore për vitin 2018 janë parashikuar në shumën 262 milionë lekë. Ky zë është realizuar në masën 93 % kundrejt buxhetit faktik. Në këtë zë është përfshirë edhe sigurimi i jetës, shendetit dhe pensionit suplementar si dhe trajtimi ushqimor.

e. Shpenzimet për dieta e shërbime

Shpenzimet për dieta dhe shërbime për vitin 2018 janë parashikuar në shumën 6.58 milionë lekë. Ky zë shpenzimesh është realizuar në vlerën 5.76 milionë lekë ose 88 % kundrejt buxhetit faktik dhe mbështet kryesisht aktivitetin e kryer nga Departamenti i Infrastrukturës për mbikqyrjen e objekteve në terren të cilat gjatë kësaj periudhe kanë qënë intensive për shkak edhe të ndjekjes së realizimit të objekteve të investimit të FZHR-së në gjithë vendin.

f. Shpenzimet e komunikimit

Në këtë zë përfshihen shpenzimet për komunikim si dhe shpenzimet e shërbimit postar. Ky zë është parashikuar 3.1 milionë lekë dhe është realizuar në vlerën 1.78 milionë lekë ose 58 % kundrejt buxhetit faktik.

g. Shpenzime të tjera

Në zërin shpenzime të tjera përfshihen shërbim interneti, facilitete dhe qera rajonale të FSHZH-së, energji elektrike, ujë, ruajtje e godinës, mirëmbajtje e sistemeve të zyrave qendrore, siguracione, seminare të stafit, blerje të vogla etj. Për këtë zë në buxhetin 2018 janë parashikuar rreth 27.79 milionë lekë. Ky zë është realizuar në vlerën 19.42 milionë lekë ose 70 % kundrejt buxhetit faktik.

h. Publikime & Promovime

Në këtë zë përfshihen shpenzimet për analizat periodike të stafit, dizajne, printime, publikime, përgatitje video dhe dokumentarë dhe njoftime të ndryshme në shtyp (njoftime për tendera, punësime, etj). Në buxhetin e vitit 2018 për këtë zë janë

parashikuar rreth 6.5 milionë Lekë. Gjatë këtij viti janë realizuar shpenzime në masën 4.65 milionë lekë ose rreth 72 % kundrejt buxhetit faktik.

i. Kontrata shërbimi dhe shpenzime gjyqësore, përkthime, noterizime

Në këtë zë përfshihen shpenzime gjyqësore dhe asistencë juridike si dhe pagesa për kontrata shërbimi. Për këtë zë në buxhetin 2018 janë parashikuar rreth 7.31 milionë lekë. Gjatë këtij viti shpenzimet për këtë zë janë në vlerën 3.59 milionë lekë ose 49.17% kundrejt buxhetit faktik.

j. Servis kompjuter dhe fotokopje

Në buxhetin e vitit 2018 për këtë zë janë parashikuar rreth 700 mijë lekë për mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike dhe fotokopjeve. Shpenzimet për këtë zë janë realizuar në vlerën 694 mijë lekë ose rreth 99 % kundrejt buxhetit faktik.

10.2 Organizim i ri institucional

Më 18 Korrik 2018, me anë të një Vendimi të Këshillit të Ministrave (VKM), u vendos "kalimi i funksioneve të Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal (AKZHR), Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik Rajonal (AZHER) dhe Agjencive të Zhvillimit Rajonal (AZHR) pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit".

Me anë të këtij vendimi synohet përgatitja e kushteve për funksionimin e reformës për zhvillimin rajonal dhe ngritja te strukturave të afta në mbështetjen e një zhvillimi të qëndrueshëm rajonal në territorin e tyre, nëpërmjet njohjes me të thelluar të territorit, koordinimit më të mirë të gjithë aktorëve me qëllim programimin efektiv të investimeve të nevojshme për zhvillimin ekonomik e social, si edhe koordinimin e monitorimin e zbatimit të tyre.

Kalimi pranë FSHZH i mundëson këtyre strukturave të ngrihen mbi përvojën 25 vjeçare të FSHZH në territor dhe me një traditë të konsoliduar bashkëpunimi dhe koordinimi me aktorët lokalë, duke i dhënë gjithashtu avantazh në ngritjen e programeve operacionale rajonale.

VKM-ja specifikon gjithashtu se FSHZH, brenda një afati kohor gjashtëmuor, duhet të kryejë ristrukturimin e nevojshem për garantimin e zbatimit të këtij vendimi. Për garantimin e këtij qëllimi, u ngrit një grup punë i cili organizoi dhe koordinoi këtë proces në mënyrë efektive, duke përfshirë njohjen me kapacitetet e agjencive dhe identifikimin e sinergjive me qëllim akomodimin e këtyre kapaciteteve sipas funksioneve të FSHZH. Në datë 6 Dhjetor 2018 Bordi miratoi strukturën e re dhe organizimin e ri institucional.

10.3 Komunikimi dhe Marrëdhëniet me Publikun

Me kalimin e funksioneve të Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal, Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik Rajonal dhe agjencive të zhvillimit rajonal te Fondi Shqiptar i Zhvillimit, filloi një proces ndryshimesh dhe ristrukturimi të brendshëm. Pjesë e procesit ishte integrimi i këtyre agjencive dhe krijimi i një identiteti të përbashkët për këto ish-agjenci nën FSHZH.

Krahas integritit të tyre nën identitetin e FSHZH filloi procesi i prezantimit të punonjësve të rinj me institucionin, historinë nga momenti i themelimit deri në ditët e sotme, vizioni për të ardhmen. Rritja e portofolit dhe diversifikimi i ndërhyrjeve bashkë me zgjerimin e kompetencave, bënë që FSHZH t'i japë një peshë më të madhe komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun.

Njësia e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun harton strategjinë e komunikimit për organizatën si një e tërë përcakton tonin dhe mesazheve që përcillen në emër të FSHZH brenda organizatës dhe jashtë. Po ashtu kjo njësi ofron edhe mbështetje për komunikimin me aktorët e interesit të projekteve që FSHZH zbaton. FSHZH mban një profil publik relativisht të ulët, por komunikon intensivisht mbi impaktin e projekteve që zbaton, si dhe u përgjigjet rregullisht kërkesave për informacion nga institucione, organizata, media dhe qytetarë të thjeshtë në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit".

Kanalet e komunikimit janë kryesisht mediat e FSHZH: faqja e internetit, faqet zyrtare në platformat sociale Facebook, Instagram dhe YouTube. Përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me gazetarët e televizioneve kryesore, gazetave dhe portaleve online, FSHZH ka informuar në mënyrë sistematike lidhur me projektet e reja, ecurinë e projekteve ekzistuese dhe impaktin e investimeve të zbatuara me qëllim zhvillimin e sektorëve të rëndësishëm të ekonomisë, si dhe për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe rritjen e mirëqenies për banorët e zonave përfituese të investimit.

Marrëdhëniet me publikun

Për ruajtjen dhe konsolidimin e reputacionit përballë palëve financuese, partnerëve, aktorëve të interesit dhe publikut të gjerë, komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun kanë synuar të sigurojnë një komunikim dinamik dhe mbi të gjitha të ndershëm. Komunikimi me audiencat e jashtme nuk mund të jetë i suksesshëm nëse informacioni nuk koordinohet mirë së brendshmi. Për këtë arsye NJKMP në bashkëpunim me të gjitha departamentet dhe PMU-të është siguruar që informacioni që ofrohet për të gjitha audiencat jashtë FSHZH të jetë i saktë dhe me cilësi.

Kërkesa për informacion

Kërkesat për informacion lidhur me statusin e objekteve që janë kontraktuar nga FSHZH, procedurat e tenderimit dhe problemet sociale që janë hasur gjatë zbatimit të projekteve - janë menaxhuar në kohë dhe me efektivitet. Në total janë administruar 8 kërkesa për informacion për procedura tenderimi, vënie në dispozicion të kontratave, të dhëna teknike për objektet ç'ka është përkthyer në përgatitjen e 85 dosjeve, disa prej tyre mjaft voluminoze, që u janë vënë në dispozicion kërkuësve. FSHZH është kontaktuar nëpërmjet kërkesave me shkrim, e-mail, por edhe nëpërmjet faqes në Facebook. Pjesë e rëndësishme e punës ka qënë menaxhimi i keqinformimit nga media të caktuara mbi projektet e zbatuara nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Në të gjitha rastet reagimi ka qënë i menjëhershëm, i mirëkoordinuar së brendshmi dhe në funksion të transparencës ndaj publikut.

Media

Puna e FSHZH-së është në vëmendjen e vazhdueshme të mediave për shkak të dukshmërisë dhe impaktit që projektet kanë. Janë përpunuar kërkesa nga gazetarë të mediave të ndryshme për FSHZH-në në tërësi, por edhe për projekte specifike. Gjatë gjithë vitit 2018 ka pasur mbi 500 raportime të mediave mbi projektet e FSHZH. Informacionet janë publikuar edhe në media që operojnë në gjuhën angleze (Albanian Daily News, Tirana Times, Invest in Albania), ç'ka rrit vizibilitetin e organizatës edhe përballë audiencave jo shqip-folëse.



Faqja zyrtare e internetit dhe faqja në Facebook, Instagram dhe YouTube janë kanalet që FSHZH përdor për të komunikuar dhe aktorët e interesit, partnerë, bashkëpunëtorë, përfitues direktë ose indirektë dhe me publikun e gjerë.

Platformat e komunikimit online janë përdorur si një instrument për të konsoliduar reputacionin dhe imazhin e organizatës si zbatuese të projekteve në terren, por edhe orientuese e zhvillimit ekonomik afatgjatë. Komuniteti i ndjekësve në Facebook është tashmë mbi 11,500. Postimet kanë qënë të përditshme dhe është dhënë informacion i përditësuar për secilin objekt dhe projekt për të cilin FSHZH është përgjegjëse. Ka një tendencë në rritje për numrin e ndjekësve, ndarjen e postimeve nga institucione të tjera qendrore dhe lokale, si dhe nga agjenci të tjera. E njëjta gjë vlen edhe për Instagram-in që tashmë ka shkuar në mbi 1,000 ndjekës.

Një pjesë e mirë e postimeve rishpërndahen nga partnerë dhe institucionet financuese, çka rrit vizibilitetin dhe audiencën. Vëmendje u është kushtuar edhe komentuesve të ndryshëm, të cilët kanë marrë përgjigje për pyetjet apo kërkesat e drejtuara.

Përdorimi i platformave sociale ka rezultuar mjaft i suksesshëm në nxitjen e kuriozitetit të mediave për t'u njohur më nga afër me projektet e FSHZH-së, ç'ka e vendos institucionin në një pozicion të favorshëm pasi në këtë mënyrë orienton informacionin publik mbi aktivitetin e vet.

Kanali në YouTube i FSHZH-së është riaktivizuar dhe përditësuar me video mbi projektet në zbatim dhe ato të përfunduara.

- **Faqja zyrtare e web-it**

Website-i zyrtar i FSHZH-së është ndërtuar rishtas duke paraqitur imazhin e një organizate moderne, dinamike, të orientuar drejt rezultateve dhe transparente për publikun.

Aktualisht po punohet për plotësimin e të gjithë informacionit të mbartur nga faqja e vjetër dhe njëkohësisht me përkthimin e informacionit në gjuhën angleze.

Për projekte të caktuara, varësisht nga kërkesat e donatorit janë krijuar nënfaqe të cilat ofrojnë informacion mbi projektin përkatës, akses në dokumente për të cilat grupet e interesuara publike kanë nevojë, lajme dhe njoftime.

Ndryshimet në faqen e re të internetit konsistojnë në:

Design-in e faqes - Faqe dinamike, e thjeshtë për tu lexuar duke përdorur pak ngjyra dhe kombinim të seksioneve me text, imazhe dhe animim.

Funksionalitetin - Faqe e strukturuar me menu shoqëruese në çdo faqe dhe krijimi i hierarkisë së nënfaqeve me qëllim orientimin e përdoruesve të rinj dhe atyre ekzistues.

Faqja është dygjuhëshe dhe ofron informacion të përditësuar edhe në gjuhën angleze.

Aksesohet jo vetëm nga web-i, por edhe nga aparatet e tjerë smart (telefona, tabletë, lpad-e).

Përditësimi i informacionit kryhet nga ndërfaqja e Wordpress e cila lejon krijimin e disa user-ave që mund të punojnë në përditësimin e informacioneve të reja. Gjithashtu kjo ndërfaqje është e thjeshtë për tu përdorur, aksesohet online nga cdo vendodhje dhe lejon përditësimin e faqes në kohë më të shpejtë.

Faqja është SEO - Optimizuar për motorët e kërkimit si Google. Faqja është e indexuar në Google.

Lidhja e faqes me rrjetet sociale si Facebook, Instagram dhe Youtube krijon mundësinë ndarjes së informacionit më shpejt në platformat sociale.

Efekti Parallax - Faqja kryesore jep një informacion të përmbledhur për të tërhequr përdoruesit e rinj.

Contact form - Mundësi për publikun që është i interesuar për pyetje të përgjithshme dhe formë aplikimi me CV.


Të dhëna statistikore

Faqja zyrtare e Fondit Shqiptar të Zhvillimit është ndryshuar duke marrë një formë të re duke filluar nga data 15 Korrik 2018. Qëllimi i ndërtimit të faqes së internetit ka qenë të ndjekim praktikën dhe teknologjitë e reja që janë sot në treg dhe të kemi një përqasje të re tek përdoruesit.

Statistika të trendit të faqes zyrtare




Country	Acquisition			Behavior		
	Users	New Users	Sessions	Bounce Rate	Pages / Session	Avg. Session Duration
	1,279 <small>% of Total: 100.00% (1,279)</small>	827 <small>% of Total: 100.00% (827)</small>	2,079 <small>% of Total: 100.00% (2,079)</small>	43.87% <small>Avg for View: 43.87% (0.00%)</small>	3.41 <small>Avg for View: 3.41 (0.00%)</small>	00:02:57 <small>Avg for View: 00:02:57 (0.00%)</small>
1. Albania	1,110 (86.63%)	702 (84.69%)	1,854 (89.16%)	42.72%	3.46	00:03:09
2. United States	44 (3.43%)	40 (4.84%)	46 (2.21%)	76.09%	1.74	00:00:37
3. Italy	30 (2.34%)	18 (2.18%)	41 (1.97%)	51.22%	2.51	00:00:55
4. Germany	17 (1.33%)	13 (1.57%)	24 (1.15%)	62.50%	3.46	00:02:04
5. United Kingdom	12 (0.94%)	7 (0.85%)	27 (1.30%)	55.56%	2.78	00:01:20
6. Kosovo	9 (0.70%)	6 (0.73%)	15 (0.72%)	26.67%	5.20	00:02:03
7. Greece	7 (0.55%)	0 (0.73%)	10 (0.48%)	00.00%	3.80	00:00:57
8. Macedonia (FYROM)	6 (0.47%)	6 (0.73%)	6 (0.29%)	16.67%	4.33	00:04:10
9. Canada	5 (0.39%)	3 (0.36%)	6 (0.29%)	33.33%	3.33	00:01:47
10. France	4 (0.31%)	3 (0.36%)	4 (0.19%)	50.00%	4.00	00:01:16




Pageviews	Unique Pageviews	Avg. Time on Page	Bounce Rate	% Exit
7,080	5,049	00:01:14	43.87%	29.36%


Page	Pageviews	% Pageviews
1. /	2,142	30.25%
2. /personat_lyc/	420	5.93%
3. /prokurime/	419	5.92%
4. /prokurime/punime-civile/	323	4.56%
5. /struktura_organizative/	297	4.19%
6. /category/kantiera/vend-vakant/	175	2.47%
7. /2019/01/29/impresco-nga-thet-tasik-forca-per-shfrytezimin-e-qendreshem-te-ekosistemeve-ne-l-sqenit-shtetodres-che-lumit-buna/	163	2.30%
8. /prokurime/tenderat-fitues/	140	1.98%
9. /projekta/	129	1.82%
10. /prokurime/sherbime/	116	1.64%

[view full report](#)



	Acquisition			Behavior		
	Users	New Users	Sessions	Bounce Rate	Pages / Session	Avg. Session Duration
	1,279	827	2,079	43.87%	3.41	00:02:57
1 Organic Search	927			37.88%		
2 Direct	197			53.11%		
3 Social	154			81.48%		
4 Referral	12			37.78%		





Identiteti Korporativ dhe brandimi

Identiteti korporativ është pjesë e rëndësishme e Fondit Shqiptar të Zhvillimit përfaqëson mënyrën sesi organizata prezantohet përpara të gjithë aktorëve të interesit, përfshirë edhe punonjësit e saj. Identiteti korporativ i FSHZH përbëhet nga Logo, tipografia, imazhet & materialet promocionale dhe rregullat e design-it korporativ.

Të gjithë elementët e mësipërm janë zbatuar në të gjithë aktivitetin e FSHZH që nga formati i shkresave deri te prezantimet publike në event apo në media.

Ruajtja e identitetit korporativ të FSHZH ka qenë pjesë e punës së NJKMP në raport me donatorët.

Gjatë vitit të ardhshëm do të punohet për përditësimin dhe detajimin e mëtejshëm të rregullave të design-it korporativ, të përmirësimit të design-it të publikimeve të FSHZH, si dhe rritjen e numrit të publikimeve për një prezantim sa më koherent.

10.4 Monitorimi dhe Vlerësimi

Gjatë vitit 2018, ka vijuar puna për monitorimin e ecurisë së projekteve kryesore në zbatim nga FSHZH. Puna për monitorimin e tyre ka konsistuar në marrjen, përpunimin, vlerësimin dhe raportimin e të dhënave dhe treguesve kryesore të ecurisë, duke përfshirë avancimin teknik dhe atë financiar. Me kërkesë të donatorëve, ministrive të linjës dhe të interesuarve të tjerë janë përgatitur raporte periodike dhe informacione që lidhen me ecurinë dhe indikatorët e performancës.

Puna për monitorimin dhe vlerësimin e projekteve është fokusuar në dy drejtime kryesore:

- Ndjekjen, monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e projekteve në zbatim dhe atyre që janë drejt përfundimit;
- Përgatitjen e kuadrit të monitorimit dhe vlerësimit të projekteve që sapo kanë filluar apo pritjet të fillojnë;

Eshtë ndjekur nga afër ecuria e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin, Projektit “Punët në Komunitet IV”, Projekti i Rehabilitimit të Segmenteve Rrugore Prioritare, “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III”, “Fondi i Investimeve Sociale IV”, “Fondi i Zhvillimit të Rajoneve”, Rruga e Lumit të Vlorës. Monitorimi bazohet në treguesit periodikë të komponentëve kryesorë të projekteve duke i krahasuar me planet e punës.

Në kuadër të përgatitjes së monitorimit dhe vlerësimit të projekteve që sapo kanë filluar nga puna apo pritjet të fillojnë, një vëmendje e veçantë i është kushtuar, Projektit të Rrugëve Lidhëse Rajonale dhe Projektit për Zhvillimin e Integruar të Zonave me Potencial Turistik.

Në kuadër të Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin, janë hartuar Termat e References për fazën e dytë të vlerësimit të impaktit dhe është përgatitur dokumentacioni i nevojshëm për tenderimin e konsulencës. Njëkohësisht janë mbledhur të dhëna statistikore dhe informacione mbi sektorin e turizmit në zonën e shtrirjes së projektit.

Në kuadër të projektit Punët në Komunitet IV, financuar nga CEB, janë përgatitur Termat e References për Vlerësimin e Përfituesve dhe ka përfunduar përgatitja e dokumentacionit shoqërues për hapjen e procedurave të tenderimit.

10.5 Auditimi i brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm, zhvillon aktivitetin bazuar në planin strategjik dhe vjetor të auditimit të miratuar në Këshillin Drejtues, si dhe në programet e aprovuara për çdo mision auditimi. Planet e auditimit bazohen në qëllimin dhe misionin e auditit të brendshëm të përcaktuar në standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm si dhe në analizën e riskut të projekteve/programeve në implementim në FSHZH.

Gjatë vitit 2018 Njësia e Auditimit të Brendshëm ka realizuar:

- Përgatitjen dhe raportimin në analizën vjetore të FSHZH dhe Këshillin Drejtues, të veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2017, planin strategjik 2018 - 2020 si dhe planin vjetor të njësisë për vitin 2018;
- Akt verifikimi të zbatimit të projektit: “Rikonstruksioni i rrugës Krujë - Qafështamë” 18.2 km;
- Shqyrtimi dhe analiza e procedurës së prokurimit të projektit: “Mbrojtja detare e projektit të mbushjes me rërë të plazhit të Vlorës”, rekomandimet përkatëse;
- Akt verifikimi të zbatimit të projektit: “Rehabilitim dhe riveshje me asfalt i rrugës Fushë Arrëz (K/Hadroit) - Reps (Rotondo) 37.5 km.
- Akt verifikimi i projektit të zbatimit: “Rikonstruksioni i Rrugës Shkodër - Velipojë (Segmenti Harku i Bërdicës - Kryqëzimi Baks) Lot I-II-III.
- Program auditimi për: “Vlerësimin e fazës së prokurimeve dhe të zbatimit të punimeve të projekteve të Programit të Rehabilitimit të Akseve Rrugore Prioritare të Qeverisë Shqiptare”, për objektet:
 - ✓ Rikonstruksioni i rrugës Cërrik - Belsh - Kuçovë - Ura Vajgurore, Segmenti Grekan - Dragot;
 - ✓ Rikonstruksioni i rrugës Gradishtë - Spolatë, segmenti Spolatë e vogël - Spolatë e madhe;
 - ✓ Rikonstruksioni i rrugës Mërtish - Tre Urat;
 - ✓ Rikonstruksioni i rrugës hyrëse të qytetit Bajram Curri;
 - ✓ Rikonstruksioni i rrugës Borje - Kufi;
 - ✓ Rikonstruksioni i rrugës Lalëz - Bizë - Draç;

- ✓ Rikonstruksioni i rrugës Korçë - Voskop - Polenë - Korçë;
 - ✓ Sistemim, asfaltim rruga Qafë Plloçë - Pogradec dhe Unaza Pogradec;
 - ✓ Rehabilitim dhe riveshje me asfalt i rrugës Fushë Arrëz (K/Hadroit) - Repts (Rrotondo);
 - ✓ Ndërtimi i unazës së qytetit Vau i Dejës;
 - ✓ Rikonstruksioni i 3 rrugëve hyrëse të qytetit të Rrogozhinës;
 - ✓ Rikonstruksioni i rrugës Taulantet, pedonale dhe KUZ, në UBT;
 - ✓ Ndërtimi i Shëtitorës Mak Albania - Pusi nr.1 dhe rikonstruksioni i Kanalit KK1(pjesa fundore);
- Program auditimi për: Auditimin e ciklit te plotë të projektit të rehabilitimit të Lumit të Vlorës, të financuar nga Fondi Kuvajtjan, Fondi Saudit dhe Qeveria Shqiptare;
 - Program auditimi i fazës së prokurimit për: Supervizionin e mbushjes me rërë të plazhit të Vlorës si dhe rekomandimet përkatëse;
 - Raport përmbledhës për dhënie informacioni “BIRN” (Balkan Investigative Reporting Network) mbi projektet e financuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.
 - Raporti i Aktivitetit për vitin 2018;
 - Plani i Aktivitetit për vitin 2019;
 - Plani Strategjik për periudhën 2019 - 2021.
 - Program auditimi për zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë në veprimtarinë ekonomiko-financiare për Projektin “Programi i Punëve në Komunitet IV - Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonave Bregdetare” për kontrata për punime civile:
 - ✓ Punimet e rikualifikimit urban në Bashkinë e Vlorës, Faza e Parë;
 - ✓ Rikualifikimi Urban, Pukë;
 - ✓ Rindërtimi i Rrugës së Ulzës;
 - ✓ Punimet e rikualifikimit urban në Bashkinë e Himarës, Faza e Parë;
 - ✓ Riparimi dhe ndërtimi i infrastrukturës rrugore, belveder dhe plazh publik, Dhraleo, Himarë;
 - ✓ Restaurimi dhe rinovimi i fasadave në zonën e mbrojtur në qytetin e Gjirokastrës;
 - ✓ Restaurimi i rikualifikimit urban në fshatin Dhërmi, Bashkia e Himarës;
 - ✓ Rikualifikimi urban, restaurimi në fshatin Vuno, Bashkia e Himarës;
 - ✓ Rigjenerimi urban i zonës bregdetare ne fshatrat Jale dhe Dhërmi, Bashkia Himarë;

Program auditimi per kontrata projektim dhe mbikqyrje:

- ✓ Projektimi për Rikualifikimin Urban në Bashkinë e Vlorës;
- ✓ Shërbimi i mbikëqyrjes për punimet civile në zonën bregdetare të fshatit Jale dhe Dhërmi, Himarë;
- ✓ Shërbimet e Mbikëqyrjes për Punë Civile në Rrugën e Ulzës;
- ✓ Projektim për Rikualifikimin Urban në Bashkinë e Himarës;
- ✓ Shërbime projektimi për Rikualifikim Urban në Dhërmi dhe Vuno Fshatrat (Bashkia Himarë);
- ✓ Projektim për rigjenerimin urban të zonës bregdetare në Fshatrat e Jalës dhe Dhërmisë, në Himarë;
- ✓ Shërbimet e Mbikëqyrjes për Rikualifikim Urban Punimet civile në Vtorë (Faza e Parë), Himarë (Faza e parë);
- ✓ Shërbimet e mbikëqyrjes për punimet civile në fshatrat Dhermi dhe Vuno, Bashkia Himarë;

Objektivi i auditimit është dhënia e sigurisë së arsyeshme menaxhimit të institucionit nëse fazat e prokurimeve dhe zbatimit të projekteve realizohen konform ligjeve e rregullave të përcaktuara, nëse risqet bazë janë identifikuar dhe menaxhuar, për mbajtjen e tyre në nivelin e pranueshëm dhe garantimin e arritjes së objektivave të përcaktuara për këtë program.

Në përgjithësi sistemi i menaxhimit të ciklit të plotë të projekteve të audituara, funksionon me efektivitet duke realizuar menaxhimin e mirë të fondeve dhe siguruar realizimin e projektit në kohën, cilësinë dhe koston e kërkuar në marrëveshjet e financimit. Procedurat e vendosura funksionojnë për të bërë kontrollin e projekteve, ndjekjen e plotë të ecurisë së punimeve, konstatimit dhe korrigjimit të defekteve gjatë fazës së zbatimit duke garantuar performancë të mirë të të gjithë procesit.

Në përfundim të auditimit u konstatua se sistemi i menaxhimit të ciklit të plotë të projekteve teknike funksionon me efektivitet duke realizuar menaxhimin e mirë të fondeve dhe siguruar realizimin e projektit në kohën, cilësinë dhe koston e kërkuar në marrëveshjet e financimit.

Procedurat e vendosura funksionojnë për të bërë kontrollin e projekteve, ndjekjen e plotë të ecurisë së punimeve, konstatimit dhe korrigjimit të defekteve gjatë fazës së zbatimit duke garantuar performancë të mirë të gjithë procesit. Gjithashtu, janë konstatuar mangësi të cilat lidhen me procedurat e vendosur të elementeve të veçantë të monitorimit dhe vënies në kontroll të plote të kontraktorëve të cilët performojnë.

Duke vlerësuar problematikat e konstatuara gjatë auditimit, njësia ka bërë vlerësimin e shkallës së riskut si dhe masën e ndikimit të tyre në objektivat e përgjithshme të projekteve.

Për të metat dhe mangësitë e vërejtura, NJAB ka lënë rekomandimet përkatëse të cilat synojnë në forcimin e mjedisit të kontrollit të brendshëm dhe rritjen e efektivitetit të sistemit për menaxhimin më të mirë të ciklit të projekteve. Zbatimi i rekomandimeve po monitorohet dhe konstatohet impenjim i strukturave të FSHZH në zbatimin e tyre.

10.6 Burimet Njerëzore

Strategjia e Burimeve Njerëzore është pjesë e strategjisë së FSHZH, në mbështetje dhe realizim të filozofisë dhe vizionit të institucionit për rritjen e efikasitetit të strukturës organizative dhe performancës institucionale. Filozofia e menaxhimit të burimeve njerëzore në FSHZH bazohet në rekrutimin dhe mbajtjen e talenteve si dhe në motivimin e stafit aktual.

Veprimtaria e Njesisë së Burimeve Njerëzore konsiston në:

- ✓ Rekrutimin dhe mbajtjen e talenteve: politikat e rekrutimit ofrojnë mundësi të barabarta dhe punësim të talenteve sipas fushës së ekspertizës së kërkuar në FShZh. Gjatë këtij viti janë punësuar 21 punonjës të rinj.
- ✓ Staf të motivuar dhe të kënaqur:
 - Vlerësim periodik i formalizuar i performancës. (kryhet çdo tremujor përkatësisht në fund të muajit mars, qershor, shtator e dhjetor)
 - Promovim mbi bazë arritjesh dhe vlerash individuale. Gjatë vitit 2018 ka pasur promovime të stafit nga një kategori më e ulët në më të lartë si dhe ndryshime të nivelit të pagës brenda të njëjtës kategori.

- Shpërndarje e stimujve moralë dhe financiarë për punonjës të mirë të vitit.
- ✓ Trajnimi i vazhdueshëm: Ngritja e kapaciteteve synon mbajtjen dhe promovimin e talenteve, çertifikimin ndërkombëtar të stafit menaxherial si dhe përditësimin e njohurive të stafit në përgjithësi me praktikën më të mirë.
- ✓ Staf etik dhe të përgjegjshëm, në përforcim të vlerave njerëzore:
 - dhurimi vullnetar i gjakut - 9 punonjës të FSHZH ishin dhurues aktivë
 - punonjësit e FSHZH dhuruan vullnetarisht në festat e fundvitit për fëmijët e pavionit të hematologjisë së spitalit pediatrik “Nënë Tereza”
 - riciklimin e letrës së përdorur nga FSHZH në bashkëpunim me kompaninë Green Recycling që mundëson grumbullimin periodik të materialeve të riciklueshme
- ✓ ODOO software është një risi që tenton të përshpejtojë dhe përmirësojë cilësinë e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave të stafit të fondit si dhe krijimin e lidhjeve në kohë reale midis departamenteve/njësive të institucionit.
- ✓ Pas vendimit nr. 438, datë 18. 07. 2018, të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e funksioneve të Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal (AKZHR), Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik Rajonal (AZHER) dhe Agjencive të Zhvillimit Rajonal (AZHR) te Fondi Shqiptar i Zhvillimit, u punua me sistemimin e stafeve të tyre, një pjesë e të cilit është përfshirur tashmë në FShZh.

Një vëmendje e veçantë nga Njësia e Burimeve Njerëzore i kushtohet aspektit gender në rekrutimin e stafit dhe arritjes së përbërjes gjinore përfaqësuese femra - meshkuj.



10.7 Misione të donatorëve

- **Mision i Bankës Botërore në kuadër të Programit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin**

Dy misione të Bankës Botërore vizituar Shqipërinë në 5-8 Shkurt dhe 29 Tetor - 9 Nëntor 2018. Objektivi kryesor i këtyre misionev ishte ecuria e zbatimit të nënprojekteve fast-track dhe aktivitetet e tjera të parashikuara në projekt ne kuader te komponenteve te tjere te projektit. Misioni diskutoi gjithashtu mbi përgatitjen e investimeve për 4 vitet e ardhshme të projektit.

Gjatë këtij misioni u zhvilluan takime me stafin e FSHZH, bashkitë përfituese dhe aktorë të tjerë në nivel qendror dhe lokal. Njëkohësisht u zhvilluan edhe vizita në terren për të parë nga afër objektet e financuara në kuadër të projektit.

Misioni konstatoi progres të konsiderueshëm në aktivitetet e projektit veçanërisht në komponentin e parë. Progres u konstatua edhe në disa aktivitete të komponenteve 2 dhe 3. Misioni vlerësoi angazhimin e FSHZH në rolin e agjencisë zbatuese të projektit.

- **Mision i Bankës së Këshillit të Europës (CEB), në kuadër të Programit “Punët në Komunitet IV”**

Një mision i Bankës së Këshillit të Europës (CEB), vizitoi Shqipërinë në 5 - 8 Shkurt 2018. Objektivi kryesor i këtij misioni ishte vlerësimi i ecurisë së projektit, përfshirë komponentin social dhe mjedisor.

Gjatë këtij misioni u zhvilluan takime me stafin e FSHZH, bashkitë përfituese dhe aktorë të tjerë në nivel qendror dhe lokal. Njëkohësisht u zhvilluan edhe vizita në terren për të parë nga afër objektet e financuara në kuadër të projektit. Misioni u koordinua me Bankën Botërore me qëllim diskutimin e mundësive për financimin e një projekti të ri investimesh në zonën e Alpeve. Në fund të këtij misioni u konstatua se projekti ka realizuar objektivat dhe detyrat e caktuara deri në këtë fazë të projektit.

- **Misione të KfW në kuadër të Programit Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III & IV dhe SIF IV**

Gjatë këtij vitii, KfW ka zhvilluar disa misione vlerësimi në Shqipëri, lidhur me ecurinë e programit Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III. Gjatë 2 misioneve të para të zhvilluara në Prill 2018, u diskutua mbi çështje të lidhura me projektimin, përgatitjen e fazës së tenderimit dhe dokumentacionit shoqërues dhe çështje të tjera të lidhura drejtpërdrejt me ecurinë e programit.

Ndërkohë në periudhën 2-4 Maj 2018, u zhvillua misioni lidhur me vlerësimin e programit Fondi i Investimeve Sociale IV (SIF IV).

Disa misione të tjera të KfW janë zhvilluar në Korrik dhe Shtator 2018, në kuadër të përgatitjeve të programit Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale IV.

Misionet konstatuan progres të konsiderueshëm në të gjithë komponentët e programeve dhe vlerësuan angazhimin e FSHZH në rolin e agjencisë zbatuese të projektit.

11. AKTIVITETE TE TJERA

11.1 Krijimi i Agjencisë Ekonomike Mbështetëse

Në zbatim të kompetencave dhe objektivave të ligjit, FSHZH prej kohësh ka konsideruar mundësitë e zgjerimit të aktiviteteve të saj për të përmbushur sa më mirë rolin e saj si agjenci kryesore në vend për nxitjen e zhvillimit në nivel rajonal dhe vendor.

Duke konsideruar sa më sipër dhe me qëllim zgjerimin e instrumenteve të ndërhyrjes, komplementimin e aktivitetit të saj, zgjerimin e portofolit të fondeve në dispozicion, gjatë vitit 2018 u krijua Agjencia Ekonomike Mbështetëse, një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K), me pronar FSHZH, e cila do të operojë si agjent ekonomik për FSHZH-në në ushtrimin e veprimtarisë së saj.

Misioni i Agjencisë është të jetë një aktor aktiv me interes publik në mjedisin e biznesit që nëpërmjet ndërhyrjeve të drejtpërdrejta financiare apo në partneritet me sipërmarrje private vendase apo të huaja të nxisë zhvillimin ekonomik në nivel lokal, rajonal dhe qendror.

Funksionet e agjencisë:

- Menaxhon dhe operon investimet e kryera nga FSHZH në marrëveshje me përfituesin për të siguruar funksionimin dhe qëndrueshmërinë e tyre afatgjatë;
- Investon, përmes formave të ndryshme të partneritetit, në asete publike apo private, ndërmarrje tregtare publike dhe në sipërmarrje biznesi private, në shërbim të interesit publik me synim zhvillimin ekonomik në nivel lokal dhe rajonal;
- Vepron si agjent ekonomik për asetet publike të transferuara tek FSHZH nga Qeveria Shqiptare;

Fusha e veprimtarisë ekonomike të AEM-se do të mbulojë kryesisht:

- Investimin dhe menaxhimin e aktiviteteve ekonomike në fushën e turizmit, kulturës, shërbimeve me interes publik, teknologjisë së informacionit, bujqësisë, energjisë së rinovueshme, aktivitet tregtar, import-eksport etj;
- Projektim, ndërtim, blerja, shitje, dhënia me qera, nën qera e pasurive të paluajtshme, duke respektuar dispozitat e ligjit në fuqi;
- Shoqëria mundet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi;

Aktiviteti i agjencisë 2018

Gjatë vitit 2018 Agjencia Ekonomike mbështetëse e fokusoi aktivitetin e saj në dy drejtime, organizimi i brendshëm, krijimi i strukturave, procedurave dhe burimeve njerëzore dhe së dyti në identifikimin dhe nisjen e sipërmarrjeve ekonomike që do të garantojnë qëndrueshmërinë financiare në fazën e fillimit të aktivitetit.

Aktivitetet kryesore kanë qënë:

Pilotimi i sipërmarrjeve të reja

- Nënshkrimi i marrëveshjes me Qendrën Spitalore Universitare dhe kalimi në administrim dhe funksionim të parkimit;
- Faza parapërgatitore për Ngritjen dhe Menaxhimin e Qendrës së Turizmit Valbonë (2019);

- Faza parapërgatitore për Ngritjen dhe Menaxhimin e Qendrës së Turizmit Vermosh (2019);

Kërkimim & Analizë e aktiviteteve të reja ku mund të investohet :

- Shfrytëzimi i investimeve që po kryhen në kuadër të projekteve që po realizon FSHZH, (Orik, Porto Palermo, Syri i kalter, Sarandë, Himarë);
- Integrim i projekteve të nisura nga AZHER (Betahaus, Qendra e Makinerive Bujqësore Cërrik, Zona turistike Darzezë);
- Identifikimi dhe shfrytëzimi i aseteve publike apo PPP me interes zhvillimi (Lista e pronave publike në nivel qendror dhe lokal, hartimi i concept paper për disa objekte);
- Identifikimi i granteve/kredive/investitoreve dhe kërkimi i financimit;

Gjatë periudhës 6-mujore të aktivitetit të saj që nga krijimi, AEM ka arritur që të ketë një qarkullim nga aktiviteti saj një fond prej 40 milionë lekësh nga të cilat të ardhura janë 33 milionë Lekë. Nga aktiviteti i AEM janë mbuluar edhe shpenzimet e shërbimit në formën e donacionit që FSHZH i ofroi QSUT-së në shumën prej 5.2 milionë lekë.

Aktivitete të parashikuara për vitin 2019

Për vitin 2019 AEM do të fokusohet në konsolidimin e aktivitetit të saj në:

- Menaxhimin e parkimit të QSUT. Në bazë të planit të biznesit dhe marrëveshjes së menaxhimit pritet që të kryhen një sërë investimesh të reja për përmirësimin e teknologjisë, pajisjeve dhe infrastrukturës pritëse në këtë territor. Të ardhurat për vitin 2019 parashikohen në shumën 105 milionë lekë;
- Projektimi dhe fillimi i zbatimit të ndërtimit të parkimit me disnivele brenda territorit të QSUTsipas marrëveshjeve paraprake, negocimi i akt marrëveshjes së re për këtë marrëdhënie;
- Ndjekja e punimeve dhe vënia në funksionim e Qendrës së Turizmit Valbonë dhe Vermosh;
- Ndjekja e punimeve dhe vënia në funksionim e Qendrës së Turizmit Vermosh (2019);
- Marrja në administrim e investimeve me fokus turizmin ngritur në asete publike nga PZHIUT në katër bashkitë pas përfundimeve të planeve të biznesit dhe menaxhimit;
- Përgatitja e planit të biznesit dhe nënshkrimi i marrëveshjes për qendrën e makinerive bujqësore Cërrik;
- Përgatitja e planit të biznesit, ndërhyrjet plotësuese në infrastrukturë dhe gjetja e financimit për Betahaus Tirana;
- Përgatitja e planit të biznesit dhe procedurat për administrimin e tokës në Darzezë dhe kërkimi i Investitorëve në bashkëpunim me Departamentin e Turizmit;
- Short-listimi i objekteve me interes nga lista e aseteve publike dhe përgatitja e projekt fishave;